Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. **Nr. 6(14). Qershor 2007** Çmimi: **50** lekë

Zhvillohet në Tiranë Kuvendi Tekniko Shkencor për rrugën e re të Dibrës

Integrimi i Dibrës kalon nga Rruga e Arbërit

Të gjithë së bashku për begatimin e Dibrës

Nga **Prof. Dr. NURI ABDIU**
FAQE 2

Nismë e mbarë na qoftë!

Nga **SHEHAT MARKU**
FAQE 4

Të ndërtojmë rrugën që do na kthejë në trojet tona

Nga **ALI HOXHA**
FAQE 4

Një Lobing për Rrugën e Arbërit

Nga **XHAFER SEITI**
FAQE 5

Nuk po kërkojmë të realizojmë trille teknologjike, por një rrugë!

Nga **HYSEN UKA**
FAQE 5



Pamje nga Kuvendi Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit. ***Foto: Baki Gurthi***

REZOLUTË E KUVENDIT TEKNIKO-SHKENCOR PËR "RRUGËN E ARBËRIT"

Kuvendi për "Rrugën e Arbërit" dëgjoi nga profesorë e inxhinierë të fushave përkatëse, alternativat e zhvillimit të vendit me vënien në funksionim të Rrugës së Arbërit.

Kuvendi shtroi alternativat për zgjidhjen sa më shpejt të probleme paraprake në mënyrë që ndërtimi i rrugës të fillojë një ditë e më parë.

Kuvendi u kërkon institucioneve qendrore në vend, veçmas Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që ta marrin seriozisht problemin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit.

Kuvendi u kërkon qeverisë dhe institucioneve përkatëse që të intensifikojnë bashkëpunimin me institucionet homologe në Maqedoni dhe institucioneve financiare të huaja për këtë çështje.

(E plotë në faqen 2)

OLLDASHI TAKOHET ME KRYETARËT E BASHKIVE TË DY DIBRAVE

Me kërkesë të pushteteve vendore të Dibrës së Vogël-Peshkopi në Shqipëri dhe Dibrës së Madhe në Maqedoni, mw 25 maj 2007, Sokol Olldashi, ministri i Transporteve të Shqipërisë priti dele gacionet e dy Dibrave të kryesuara nga Ilir Krosi dhe Argëtim Fida një ditë para mbajtjes së Kuvendit Tekniko-Shkencor për "Rrugën e Arbërit". Në këtë takim mernin pjesë edhe deputetët Rahim Kaleci dhe Agron Buxhaku. Takimi u zhvillua në atmosferë mjaft konstruktive dhe u elaborua rëndësia gjithëshqiptare dhe rajonale e këtij korridori. Nga kryetarët e bashkive u kërkua promovimi dhe lobimi nga Qeveria shqiptare që sa më parë të gjenden mjetet e nevojshme për fillimin dhe ndërtimin e kësaj rruge. Premtimet e ministrit ishin shumë serioze, sepse Qeveria shqiptare tashmë ka miratuar projektin e pjesës së rrugës Dibër e Vogël-Bulqizë, për cka është caktuar granti prej 25 milionë dollarësh dhe pritet që punimet të fillojnë vitin që vjen. Ministri Olldashi ishte shumë i informuar lidhur me ndërtimin e "Rrugës së Arbërit" dhe shprehu gatishmërinë e Qeverisë dhe Ministrisë së Transporteve të Shqipërisë për të mbështetur fuqimisht ndërtimin e kësaj rruge.



Kronikë e një greve të paralajmëruar

FAQE 6

Trupa e teatrit profesionist të pallatit të kulturës së Peshkopisë "Haki Stërmilli" shaq dramën "Letër Orestit"

"Tragjedia ka ndodhur në Dibër"

Faqe 12

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Sheh Mera zbret në konakun e Fik Remës

Nga **NAIM PLAKU**
FAQE 11

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com. www.dibra.org

Të gjithë së bashku për begatimin e Dibrës

Prof. Dr. NURI ABDIU*

Ndjehem tepër i nderuar që në emër të Kryesisë së Shoqatës LID dhe të **shoqatave të tjera dibrane,** që kanë marrë pjesë në organizimin e këtij kuvendi të rëndësishëm, të ju uroj mirëseardhjen.

Kuvendi ynë Tekniko – Shkencor, që po mbajmë, nuk është caktuar rastësisht për në ditën e sotme. Kjo ditë përkon me *njëvjetorin e promovimit të shoqatës sonë Lidhja e Intelektualëve Dibranë,* që u bë më 27 maj të vitit 2006.

Siç e shihni, ne sot përkujtojmë edhe njëvjetorin e saj. Periudha njëvjeçare, flet për atë që LID ka një histori të shkurtër, por, LID ka një parahistori më të gjatë dhe një veprimtari të shënuar. Ka një parahistori më të gjatë, sepse, grupi nismëtar për themelimin e saj e kishte filluar veprimtarinë e vet që në muajin maj të vitit 2004.

Gjithashtu, jo rastësisht edhe gazetës sonë të pavarur ia kemi vënë emrin "Rruga e Arbërit". Dhe ajo këtë emër po e justifikon dhe e meriton plotësisht, sepse që në nr. 1 të saj që doli më 27 maj 2006 e në vazhdim, i ka bërë jehonë Rrugës së Arbërit. Gjithashtu, dhe fillimin e punës për ndërtimin e saj, që ka qenë, e deri më sot mbetet ëndrra shekullore e dibranëve, e konsiderojmë si detyrën më kryesore, jo vetëm të Shoqatës sonë, por si një shqetësim mbarëdibrane. Prandaj, për organizimin bashkërisht të këtij Kuvendi, ftuam edhe shoqatat e tjera dibrane, të cilat edhe më përpara, kishin dhënë kontributin e tyre për sensibilizimin e opinionit qytetar e shtetëror, për ndërtimin e kësaj rruge. Ju shprehim falënderime, si për pjesëmarrjen, ashtu dhe për sugjerimet e mendimet e tyre të vyera.

Qëllimi kryesor i këtij Kuvendi, është argumentimi i domosdoshmërisë për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge, sa të jetë e mundur më parë. Është sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm, gjithëpërfshirës i shoqatave, i deputetëve e pushtetarëve, i intelektualëve e biznesmenëve dibranë, duke praktikuar me efikasitetin e duhur të gjitha rrugët dhe mjetet demokratike. Ne sot mendojmë të miratojmë edhe një rezolutë, që do t'ia dërgojmë Qeverisë, ku të kërkojmë që t'i jepet e drejta që i takon popullit të qarkut të Dibrës dhe të gjitha krahinave, nëpër të cilat ajo do të kalojë, për të udhëtuar normalisht; e drejta për zhvillim, prosperitet, etj.

E veçanta e Kuvendit tonë është se me nismën e intelektualëve dibranë, nga të dyja anët e kufirit, mblidhemi të gjithë së bashku për të diskutuar për Rrugën e Arbërit, për perspektivën që i hap ndërtimi i saj zhvillimit dhe begatimit të njërës nga krahinat më vitale të Kombit me një histori shumë të vjetër dhe shumë të pasur, Dibrës sonë, zhvillim ky që paraqet interes të veçantë dhe do të rrezatojë në të gjitha trevat përreth.

Ky Kuvend, përveç të tjerash është edhe dëshmi e vitalitetit të intelektualëve tanë, e vetëdijes së tyre profesionale, e përkushtimit atdhetar dhe e idealeve të tyre kombëtare.

Në të, jo vetëm marrin pjesë, por japin dhe ndihmesën e tyre të vyer, specialistë të studimit dhe të ndërtimit të rrugëve si nga Gostivari e Tetova, ashtu dhe nga Dibra e Madhe, etj; për të ndriçuar e vërtetuar shkencërisht, domosdoshmërinë e ndërtimit dhe vlerat e kësaj rruge, si për Republikën e Shqipërisë, ashtu dhe për Republikën e Maqedonisë e më gjerë.

Organizmi i këtij tubimi shkencor, padyshim, përbën një ndërmarrje serioze dhe nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të biznesmenëve dibranë që kanë sponsorizuar përgatitjen dhe mbajtjen e tij, nuk mund të realizohej dhe pa ndihmën e specialistëve dibranë, që kanë përgatitur materialet e këtij kuvendi. I falënderojmë për ndihmesën dhe punën cilësore që kanë bërë!

Në mënyrë të veçantë falënderojmë specialistët nga Tetova, Shefki Aliti e Llazo Cakar, që pranuan ftesën tonë dhe do të referojnë në këtë kuvend, për vazhdimin e kësaj rruge në territorin e Maqedonisë; studiuesin e vjetër, Prof. Dr. Valter Shtyllën, që do të referojë për lashtësinë e kësaj rruge, Dr. e shkencave, Inxh. Farruk Kabën, që do të paraqesë një përmbledhje të Studimit të Fizibilitetit të kësaj rruge, të miratuar në Këshillin Kombëtar të Rrugëve, që në korrik të vitit 2004, si dhe gjithë grupin e Studimit të Fizibilitetit, e në veçanti Inxhinjerin e vjetër Piro Bedo, specialistin Edmond Alite, anëtarë të këtij grupi, si dhe specialistët dibranë, që kanë marrë pjesë në këtë grup studimi, Bashkim Lleshin, Orhan Sakiqin dhe Tefik Jegenin, gjeologun matjan Agim Shenjatari, që do të referojë për Resurset (prurjet) e Matit që vihen në lëvizje me ndërtimin e rrugës së Arbërit, gjeologët dibranë Vesel Hoxha, Ilir Alliu, Naim Karaj e Sefedin Shabani që kanë përgatitur Referatin për zhvillimin që do të marrin pasuritë e rajonit të Dibrës me ndërtimin e kësaj rruge dhe gjeologun e vjetër dibran, Avni Dibra, që ka marrë pjesë në përgatitjen e referatit për zhvillimin që do të marrë turizmi malor, veror e dimëror dhe ai historik.

Falënderojmë, gjithashtu, anëtarët e Komisionit Qendror organizues të këtij kuvendi, Komisionit Tekniko – Shkencor, sponsorët kryesorë , biznesmenët: Rakip Suli, Sadri Abazi, Musa Riçku, Shaban Bitri, Preng Doçi dhe, gjithë biznesmenët e tjerë që i kemi shënuar në ftesë dhe në banderolën e këtij aktiviteti; operatorin e palodhur Sami Selishta, që ka përgatitur dokumentarin për Rrugën e Arbërit; kryeredaktorin e gazetës "Rruga e Arbërit" Shaqir Skarra, nismëtarin dhe organizuesin kryesor të tij, specialistin e vjetër dibran Bashkim Lleshi, e djalin e palodhur e të talentuar të Dibrës Bujar Karoshi, të cilët, kanë përgatitur, redaktuar e sistemuar për botim e referim të gjitha materialet e Kuvendit, si edhe gjithë dibranët e tjerë që na kanë ndihmuar për mbarëvajtjen e këtij Kuvendi.

Ndërtimi i rrugës së Arbërit, do të përbëjë një hop të vërtetë në jetën e rajoneve nga do të kalojë edhe shumë më gjerë.

Duke ju falënderuar të gjithëve edhe për vërejtjet, sugjerimet e mendimet me vlerë që do të na jepni, në emër të kryesisë së LID në Tiranë, i uroj këtij Kuvendi punë të mbarë!

Të nderuar pjesëmarrës, dhe tani, para se të fillojmë me kumtesat e përgatitura, më lejoni t'u prezantoj mysafirët tanë që na kanë nderuar me praninë e tyre në këtë kuvend:

NGA MAQEDONIA: z. Agron Buxhaku, deputet në Kuvendin e Maqedonisë, ish ministër i transporteve, z. Argëtim Fida, kryetar i Komunës Dibër, z. Nizamedin Prapaniku, kryetar i këshillit komunal të Dibrës, z. Shehat Marku, kryetar nderi i Shoqatës "Votra dibrane" në Dibër të Madhe, zShefki Aliti, projektues gjenaral i autostradës "Rruga e Arbërit" dhe autostradave kryesore në Maqedoni, z. Turhan Rusi e Z. Arben Rusi, etj., si dhe deputetët: z.Sali Shehu, z Sadri Abazi, z. Rrahim Kaleci, z. Xhafer Seiti, Prefekti i Dibrës, , Z. Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, z. Roland Keta, kryetari i Bashkisë së Bulqizës, z. Adil Neziraj, drejtorin e përgjithshëm te gjeologjisë, etj.

** Fjala e mbajtur në hapjen e Kuvendit Tekniko-Shkencor , **Tiranë më**, 26. 05. 2007*



Foto: B.Gurthi

Të gjithë së bashku për të diskutuar për Rrugën e Arbërit, për perspektivën që i hap ndërtimi i saj zhvillimit dhe begatimit të njërës nga krahinat më vitale të Kombit me një histori shumë të vjetër dhe shumë të pasur, Dibrës sonë, zhvillim ky që paraqet interes të veçantë dhe do të rrezatojë në të gjitha trevat përreth.

REZOLUTË

e Kuvendit tekniko-shkencor për "Rrugën e Arbërit"

Ne, përfaqësues të Shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", "Nisma Dibrane", "Bashkësia Dibrane", "Votra Dibrane", u mblodhëm sot më 26 Maj në Tiranë, në këtë Kuvend për të diskutuar mbi alternativën më të mirë të zhvillimit të Dibrës në veçanti e gjithë Shqipërisë në përgjithësi: **Ndërtimin e Rrugës së Arbërit.**

Kuvendi për "Rrugën e Arbërit" dëgjoi nga profesorë e inxhinierë të fushave përkatëse, alternativat e zhvillimit të vendit me vënien në funksionim të Rrugës së Arbërit.

Kuvendi shtroi alternativat për zgjidhjen sa më shpejt të probleme paraprake në mënyrë që ndërtimi i rrugës të fillojë një ditë e më parë.

Kuvendi u kërkon institucioneve qendrore në vend, veçmas **Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që ta marrin seriozisht problemin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit.**

Kuvendi u kërkon qeverisë dhe institucioneve përkatëse që të intensifikojnë bashkëpunimin me institucionet homologe në Maqedoni dhe institucioneve financiare të huaja për këtë çështje.

Kuvendi u kërkon këtyre institucioneve që të dëshmojnë me veprime konkrete atë që kanë premtuar para gjithë popullit në përgjithësi e para dibranëve e matjanëve në vecanti, se janë të gatshëm e po punojnë që Rruga e Arbërit të bëhet sa më shpejt.

Kuvendi u shpreh se çdo hap i vonuar në këtë drejtim nga institucionet vendimmarrëse është mungesë vullneti dhe serioziteti para publikut.

Kuvendi i kërkon opinionit publik, që në këtë kuadër, të mbajnë nën vëmendje hapat e mëtejshme të institucioneve vendimmarrëse.

Kuvendi u kërkon deputetëve të zgjedhur nga populli i zonave ku kalon Rruga e Arbërit, zotërinjëve Shpëtim Idrizi, Leonard Demi, Idriz Xhumara, Sali Shehu, Rrahim Kaleci, Genc Sharku, Sadri Abazi, Albert Farruku, Qemal Minxhozi, që të ushtrojnë të drejtat e tyre parlamentare, për të venë në lëvizje gjithë mekanizmat e ekzekutivit, në mënyrë që ky projekt madhor të bëhet realitet, që dita e Rrugës së Arbërit të jetë sa më afër.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI.** Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA.**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,**
ADRESA E GAZETËS: **Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.**
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: **lid_gazeta@yahoo.com**

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Zhvillohet në Tiranë Kuvendi Tekniko Shkencor për rrugën e re të Dibrës

Integrimi i Dibrës kalon nga Rruga e Arbërit

Më 26 maj në Hotel "Tirana International", shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë në bashkëpunim edhe me shoqatat e tjera dibrane organizoi Kuvendin Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit. Në këtë kuvend merrnin pjesë intelektualë, inxhinierë të ndërtimit e infrastrukturës, përfaqësues të pushtetit vendor nga kalon Rruga e Arbërit dhe atyre qendrorë, deputetët e Dibrës: Sali Shehu, Rahim Kaleci, Sadri Abazi, Albert Faruku, Prefekti i Dibrës - Xhafer Seiti, kryetari i Bashkisë së Peshkopisë dhe Bulqizës, Ilir Krosi dhe Roland Keta, si dhe shumë të tjerë.



Pamje nga Kuvendi Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit. ***Foto: Baki Gurthi***

Gjithashtu, në këtë Kuvend ishin të pranishëm edhe deputeti i Dibrës në Kuvendin e Maqedonisë, ish. ministri i Transporteve, Agron Buxhaku; Kryetari i komunës së Dibrës, Argëtim Fida; Kryetari i Këshillit Komunal, Nizamedin Prapaniku, etj.

Kuvendin e hapi kryetari i LID, Prof. Dr. Nuri Abdiu. Në përshëndetjen e tij, ai theksoi se "Qëllimi kryesor i këtij Kuvendi, është argumentimi i domosdoshmërisë për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge, sa të jetë e mundur më parë. E veçanta e Kuvendit tonë është se me nismën e intelektualëve dibranë, nga të dyja anët e kufirit, mblidhemi të gjithë së bashku për të diskutuar për Rrugën e Arbërit, për perspektivën që i hap ndërtimi i saj zhvillimit dhe begatimit të njërës nga krahinat më vitale të Kombit, me një histori shumë të vjetër dhe shumë të pasur, Dibrës sonë, zhvillim ky që paraqet interes të veçantë dhe do të rrezatojë në të gjitha trevat përreth".

Më pas përshëndeti edhe kryetari i nderit i Shoqatës "Votra Dibrane", z. Shehat Marku. Në diskutimin e tij ai e vuri theksin te nevoja e ndërtimit të Rrugës së Arbërit, si domosdoshmëri e ruajtjes së integritetit dhe unitetit kombëtar. "Jam i bindur se ndërtimi i lidhjeve infrastrukturore me transformimet e reja demokratike botërore do të flakin trashëgimitë e shëmtuara të shovinizmave fetare dhe ndërnacionale në Ballkan. Me këtë do të realizohet e drejta e integrimeve të këtyre shteteve në Evropë, shtëpi e përbashkët e etnive të saja". "Infrastruktura ndër popujt e Ballkanit, - theksoi ai, - ka një peshë të madhe, si në pikëpamje historike, ekonomike, kulturore, sociale, ashtu edhe për zhvillim të dëshiruar gjithë popullor, demokracinë në këto transformime, e sidomos ndihmesa kryesore për integrimet në Evropë, të cilët do të realizojnë të drejtat e popujve që jetojnë të ndarë, të mund të jetojnë kombëtarisht në këtë epokë të re. Infrastruktura evropiane e ndërtuar edhe ndër trojet tona etnike është nerv i vetëm dhe i domosdoshëm për zhvillime ekonomike, për çlirim kombëtar, për emancipim kombëtar të barabartë, që do të mundësojë shfrytëzimet e resurseve natyrore dhe mençuritë e njeriut shqiptar".

Duke e lidhur me historinë, z. Marku tha se "ne dibranët trashëgojmë të drejtë të veçantë historike, që, me heronjtë tanë kombëtarë si Gjergj Kastriot Skënderbeu, të kërkojmë zhvillimet infrastrukturore ndër trojet tona edhe prej Evrope. Ajo na ka borxh të flakë hipotekën e saj ndaj nesh që prej shekullit të kaluar. Të paguajë gjakun e Kastriotëve, kur ky komb qe i vetmi në Ballkan që i doli në mbrojtje nga despotizmi okupues osman. Kjo ndërmarrje dobisjellëse për Ballkanin, Evropën e më gjerë, duhet ta kuptojnë politikanët e sotëm si detyrë primare se ndërtimi i infrastrukturës ndër trojet shqiptare është domosdoshmëri me interes ekonomik, politik, social dhe kulturor". Më poshtë, z. Marku propozoi hartimin e një programi të konkretizuar për rëndësinë e kësaj rruge, sensibilizimin e popullit prej Tirane deri në Tetovë, sensibilizimin e biznesit në dy anët e kufirit, në mënyrë që Rruga e Arbërit të ndërtohet sa më shpejt. "Kjo rrugë është monumentale, ngrehinë që rrit vlerat e panumërta për këto popuj të kësaj ane, sigurojmë ardhmëri ndër breza që vijnë të barabartë me Evropën, bëjmë një vepër që vlen më shumë se çdo e mirë që mund t'ju bëhet këtyre popujve", - përfundoi ai.



Foto: B.Gurthi

Më pas, për rreth 300 të pranishëm në sallë u shfaq dokumentari "Rruga e Arbërit - një realitet", me producent Rakip Sulin (Aurora Group), me regji të Sami Selishtës dhe skenar të Bujar Karoshit. Në 15 minuta u shfaq gjithë historia rrugës nga mesjeta deri më sot. Dokumentari nxori në pah edhe domosdoshmërinë e ndërtimit të saj, si dhe risolli në kujtesë gjithë angazhimin qytetar në 15 vitet e fundit për fillimin e punimeve për rrugën. Gjithashtu, dokumentari solli në kujtesë edhe premtimet e qeveritarëve dhe partive politike për ndërtimin e saj sa më parë.

Më pas, u referuan materialet shkencore të përgatitura për këtë rast.

Prof. Dr. Valter Shtylla mbajti referatin me temë "Rruga e Arberit, rruga kryesore e vendit, krahas rruges egnatia që në lashtësi". Më pas, Dr. Ing.Faruk Kaba, në emër të grupit të punës së studimit të fisibilitetit, të përbërë Dr. Inxh. Faruk Kaba, Inxh. Piro Bedo, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Inxh.Tefik Jegeni, Dr. Orhan Sakiqi, Msc. Ekon. Edmond Alite, mbajti referatin: Studim për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit, një përmbledhje e studimit të fizibilitetit.

Më pas, Ing. Shefki Aliti referoi temën "Rruga e Arbërit në territorin e Maqedonisë: Dibër – Gostivar – Tetovë - Shkup".

Prof. Dr. Ilir Alliu, në emer të grupit të punës së përbërë nga Dr. Vesel Hoxha, Prof.Dr. Bashkim Lleshi, Inxh. Sefedin Shabani, Dr. Naim Karaj, referoi mbi "Pasurite minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e rrugës së Arbërit".

Ndërsa Msc. Inxh. Agim Shenjatari referoi mbi "Pasuritë natyrore të rrethit të Matit që vihen në shfrytëzim me ndërtimin e Rrugës së Arbërit".

Prof. Dr. Bashkim Lleshi dhe Inxh. Avni Dibra mbyllën seancën me referatin me temë: "Rruga e Arbërit dhe resurset natyrore te rrethit te Matit".

Pas dëgjimit të këtyre studimeve nga autoritetet shkencore, u zhvilluan diskutime.

Prefekti i Dibrës, Xhafer Seiti, theksoi në fjalën e tij se Rruga e Arbërit është një prioritet në detyrën shtetërore që mban. "I bindur për domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, e kam përcjellë këtë rekomandim në Këshillin e Ministrave, ministritë përkatëse dhe për gjithë deputetët që kam menduar se e kanë një lidhje me këtë qark, duke e renditur në vendin e parë të prioriteteve dhe duke u përqëndruar pikërisht në ato argumente, që studiues brenda radhëve tuaja kanë renditur si elementë që rrisin domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge. Njëkohësisht, për vetë natyrën dhe mundësitë që më jep detyra ime, këtë problem e kam diskutuar me gjithë të huajt me të cilët jam takuar, duke gjetur mundësitë të dal te tema e bisedës natyrshëm, të bind bashkëbiseduesin apo bashkëbiseduesit për rëndësinë e kësaj vepre, të qartësoj se nuk po e përdor si shtesë apo "xhep" të axhendës së bisedimeve, por një konsideratë prioritare të punës sime". "Mendoj se ka ardhur koha, - tha Prefekti Seiti, - për të pasur tanimë një lobing veprues që të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, të nxisë qeverinë dhe deputetët, të sensibilizojë opinionin, që edhe ai të bëhet pjesë e kërkesës. Kur ndërton thjesht një shtëpi ka vlerë qoftë dhe një gur i vënë në themelet e saj nga persona të caktuar e jo më kur mendon të ndërtosh një rrugë të tillë me aq vlera për të gjithë. Populli i rajonit të Dibrës, para se të mendojë për të shkuar në Evropë, duhet të lidhet më shpejt me Tiranën. Kam qenë dhe jam krah jush, krah të gjithë dibranëve, matjanëve e bulqizakëve, i gatshëm të jap dhe në të ardhmen ndihmën time modeste", - përfundoi ai diskutimin e tij.

"Komisioni organizator duhet të kishte planifikuar një fjalim në këtë Kuvend të Kryeministri të vendit, ish-ministrit të transporteve dhe ministrit aktual të transporteve, të cilët kanë premtuar ndërtimin e Rrugës së Arbërit në Dibër, Mat e Bulqizë, pasi kështu do kishim edhe mbështetjen e qeverisë aktuale në nismën e Kuvendit të intelektualëve dibrane, për t'i dhënë rëndësinë e duhur kësaj rruge për gjithë trevat shqiptare", - tha në diskutimin e tij Shemsi Prenci. Po ashtu, ai theksoi se "grupi i deputeteve, që aktualisht janë në parlamentin shqiptar me votën e banorëve të Dibrës, Bulqizës, Matit e Tiranës, ku përshkon Rruga e Arbërit, duhet të krijojnë lobingun dhe t'i bëjnë presion qeverisë, pasi ata janë në numër më shumë se grupi parlamentar i Partisë Demokristianë, që "thithin" nga kjo qeveri një post ministror apo më shumë. Ky grup deputetësh nuk kërkon poste, por të kërkojnë investime për të zhvilluar zonën e Dibrës".

Më pas, në diskutimet e tyre, deputetët Rahim Kaleci dhe Sali Shehu vunë theksin se Rruga e Arbërit nuk është një premtim. Ajo është një realitet që do të vihet në zbatim në vitin 2009. Ndërkohë, ata hodhën edhe disa dyshime mbi studimin e fizibilitetit, duke nxjerrë nevojën e një bashkëpunimi të grupit të punës me organizmat qeveritarë, në mënyrë që të sheshohen mosmarrëveshjet me qeverinë për çështje të ndryshme të projektit të studimit. Për këtë ata morën iniciativën të shërbenin si ndërmjetës në këtë proces, që përsa i përket studimit të eliminohen gjithë mangësitë e mundshme. Në këtë mënyrë nuk do ketë pengesa burokratike për fillimin e punimeve në vitin 2009.

Hysen Uka, në referatin e tij, vuri theksin në ngritjen e një "Forumi të Nxitjes së Investimeve për Dibën". Ky forum, sipas tij, të përbëhet nga specalistë të niveleve të larta, të fushave të ndryshme, të financave dhe të ekonomisë, të inxhinierisë dhe ndërtimtarisë, ekspert të proceseve të integrimit rajonal e europian, ekspertë të menaxhimit të resurseve, vizionarë që kanë promovuar me sukses ide të tyre origjinale dhe administratorë të suksesshëm. Gjithashtu, ai propozoi në organizimin e një aktiviteti të përvitshëm "Ditët e Arbërit". Ditët e Arbërit do të jenë disa ditë takimesh, të të gjithë atyre që e ndjejnë vetën arbëror, kudo që janë që nga arbëreshët e Italisë, emigracioni i të gjitha brëzave, në Amerikë apo Europë, të rinj e banorë të Tiranës, Dibrës e rajoneve të tjera që përshkohen nga Rruga e Arbërit".

Në fund të Kuvendit u lexua përshëndetja e kryetarit të shoqatës "Votra Dibrane, z. Shpëtim Cami, i cili për arsye shëndetësore nuk mundi të jetë i pranishëm në takim.

Në fund u miratua edhe Rezoluta përkatëse, e cila u është dërguar autoriteteve shtetërore në vend, deputetëve dhe institucioneve përkatëse, ku kërkohet një ditë e më parë të realizohet ëndrra gjysëmshekullore e gjithë dibranëve.

Korresp. i "Rruga e Arbërit"

Nismë e mbarë na qoftë

Nga **SHEHAT MARKU**, *Dibër*

Të gjithë të pranishmëve nderimet e mia

Jam i sigurt se të bashkuar në të gjitha drejtimet për realizimin e kësaj rruge së pari i dalim zot kombëtares për të realizuar të drejtën e natyrshme, të jetojmë të lirë kombëtarisht, me këtë ndërlidhje infrastrukturore; së dyti flakim prëfundimisht pamundësitë që ushtruan të tjerët kundër vullnetit gjithëkombëtar të mos jetojmë të lirë kombëtarisht në trojet tona etnike.

Ndarjet makabre që ju bënë kombit tonë u lejua paradoks arbitrar më i shëmtuar i shovinizmit ortodoks rus bënë atë që rëndë kanë vrarë ndërgjegjen civilizuese të Evropës në mbrojtje të krishterimit. Luftërat çlirimtare ballkanike të popujve pa turp u shndërruan në luftëra hegjemoniste në interes të shteteve ortodokse ballkanike. Duke copëtuar etninë kombëtare shqiptare me të vetmin qëllim ta shkombëtarizojnë, asimilojnë duke ndarë Çamërinë, Kosovën.

Jam i bindur se ndërtimi i lidhjeve infrastrukturore me transformimet e reja demokratike botërore do të flakin trashëgimitë e shëmtuara të shovinizmave fetare dhe ndërnacionale në Ballkan. Me këtë do të realizohet e drejta e integrimeve të këtyre shteteve në Evropë, shtëpi e përbashkët e etnive të saja. Sikur jam i bindur se politika ortodokse sllavomane ruse në Evropë e sidomos në Ballkan, edhe në ditët e sotme dëshiron të gjallërojë, alias me kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës që është e papranueshme në kuptimin e civilizimit global botëror e papranueshme edhe për vetë popullin rus, sepse ndarjet në blloqe kanë qenë gjithmonë fatkeqësi e Evropës. Përsëritja e saj prodhon vetëm kataklizmi më të tmerrshme që mund t'i shkaktohet njerëzimit në tërësi.

Politikat shoveno-fetare kudo në botë nxisin egërsi të pallogaritshme të terrorizmit botëror, ndjellin armiqësi të pashërueshme në proceset e zhvillimeve demokratike me emancipimin civilizues botëror që udhëheqin SHBA-të.


Foto: B.Gurthi

Përfundimisht është kuptuar prej tërë shteteve progresive se kolonializmi i trojeve të çdo populli ka përfunduar përgjithmonë. Legalizimi për vetë vendosje të popujve si bazë kryesore e Kartës së OKB-së për popujt kompaktë me territor, gjuhë dhe kulturë të definuar në asnjë definim social, filozofik e njerëzor është anticivilueze, e dënueshme dhe tërësisht e papranueshme. Antishqiptarizmi ruso-orthodoks në mbrojtje të okupimeve ortodokse janë tejet të rrezikshme dhe për botën në tërësi meqë është në kundërshtim të prerë me Kartën e OKB-së që mundësoi realizimin dhe realizon në vazhdimësi vetëvendosjen e popujve të okupuar sepse është e drejtë e natyrshme e pakontestueshme dhe e pavdekshme.

Gjithashtu është e papranueshme trashëgimia megalomane e shovinizmit sllav i cili në Ballkan ka lënë plagë të rënda mes popujve, ka gjymtuar sovranitetit e shteteve ballkanike duke i lënë në varësi të shovinizmit krishterë ortodoks në Ballkan. Tenton të destabilizojë edhe në ditët e sotme situatën me gjakderdhje, pa turp fashizmit serb në shekullin e XX i jep të drejtë të sundojë popujt e kolonizuar prej para një shekulli edhe pse u dëshmua botërisht se veprimet gjeoncidiale shtetërore serbe ishin, ngelin dhe do të jenë prodhime historike të pashërueshme ndër popujt e Ballkanit.

Zotërinj, e bëra këtë hyrje jo që ju nuk e dini, por duke dashur të vlerësoj peshën e madhe që ka infrastruktura ndër popujt e Ballkanit si në pikëpamje historike, ekonomike, kulturore, sociale dhe për zhvillim të dëshiruar gjithë popullor, demokracinë në këto transformime, e sidomos ndihmesa kryesore për integrimet në Evropë të cilët do të realizojnë të drejtat e popujve që jetojnë të ndarë, të mund të jetojnë kombëtarisht në këtë epokë të re. Këto integrime evropiane të këtij shekulli janë të pandaluara me sistemin e ri botëror. Infrastruktura evropiane e ndërtuar edhe ndër trojet tona etnike është nerv i vetëm i domosdoshëm për zhvillime ekonomike, për çlirim kombëtar, për emancipim kombëtar të barabartë, që do të mundësojë shfrytëzimet e resurseve natyrore dhe mençuritë e njeriut shqiptar.

Marr të drejtën t'ju them. Ne dibranët trashëgojmë të drejtë të veçantë historike, që me heronjtë tanë kombëtarë si Gjergj Kastriot Skënderbeun të kërkojmë zhvillimet infrastrukturore ndër trojet tona edhe prej Evrope. Ajo na ka borxh të flakë hipotekën e saj ndaj nesh që prej shekullit të kaluar. Të paguajë gjakun e Kastriotëve kur ky komb qe i vetmi në Ballkan që i doli në mbrojtje nga despotizmi okupues osman.

Së fundmi kjo ndërmarrje dobisjellëse për Ballkanin, Evropën e më gjerë duhet ta kuptojnë politikanët e sotëm si detyrë primare se ndërtimi i infrastrukturës ndër trojet shqiptare është domosdoshmëri me interes ekonomik, politik, social dhe kulturor.

Në këtë kuptim propozoj:

1) Të hartojmë një program të konkretizuar për vlerat e kësaj rruge, rëndësinë e saj ekonomike për integrime të gjithëmbarshme dhe emancipuese për Evropën në tërësi.

2) Të sensibilizojmë popullin prej Tirane deri në Tetovë që të ngrenë në këmbë forcat që kanë, ta mobilizojmë atë nëpërmjet shoqatave, partive si dhe gjithë poreve shoqërore.

3) Të mobilizojmë biznesin shqiptar dhe maqedon me perspektivat që u siguron kjo rrugë, program bindës se kjo iniciativë ka vlera të shumnashme të barabartë të dy fqinjve shqiptaro-maqedonas.

4) Të tentojmë mobilizimin, ta drejtojmë në këtë territor që sjell mirëqënie me karakter të gjerë e cila ka rëndësi të padiskutueshme.

5) Kjo rrugë do të ndërpresë emigracionin dhe boshatisjen e tokës mijëvjeçare që sundojmë.

Kjo rrugë është monumentale, ngrehinë që rrit vlerat e panumërta për këto popuj të kësaj ane, sigurojmë ardhmëri ndër breza që vijnë të barabartë me Evropën, bëjmë vepër që vlen më shumë se çdo e mirë që mund t'ju bëhet këtyre popujve.

Të ndërtojmë rrugën që do na kthejë në trojet tona

Nga ALI HOXHA*

Si njëri nga anëtarët e grupit nismëtar lidhur me propagandimin e ideve për ndërtimin e kësaj rruge, ndjej një kënaqësi të veçantë që sot ndodhem i pranishëm në këtë takim.

Rreth 15 vjet më parë, kur ideatorët e parë të kësaj nisme, zotërinjtë Hysen Uka dhe Bujar Karoshi, më parashtruan idenë e tyre për këtë problem duke më kërkuar edhe bashkëpunimin tim me ta, unë e pranova me kënaqësi (për të qenë i sinqertë, për një çast u stepa në vetvete, sepse për kushtet e atëhershme m'u duk si utopi) dhe mendimi i parë që shpreha qe rekomandimi im që u bëra atyre për të kontaktuar me z. Iljaz Kaca në Peshkopi, pasi për një studim timin të viteve '70-të, "Për lokalizimin e Fushës së Betejës së Torviollit" të 29 qershorit 1944, unë kisha shfrytëzuar, ndër të tjera, edhe një studim të Iljaz Kacës, atëherë me dorëshkrim, për "Rrugët e vjetra të Dibrës".

Kjo bisedë midis nesh ka qenë guri i parë i rrokullisur rreth të cilit u ngjesh orteku i madh që ka arritur sot deri këtu, në këtë Kuvend Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit, duke i kthyer idetë "utopike" në realitet.

Rruga e Arbërit do t'i japë një nxitje dhe një hop të madh zhvillimit ekonomik dhe kulturor trevës së Dibrës, si dhe të krahinave të tjera veri-lindore, në të dy anët e saj e më gjerë, duke i nxjerrë ato nga ai izolim total i derisotëm, por para së gjithash, "Rruga e Arbërit", me zhvillimin që do t'i japë krahinës, do të shërbejë edhe si një garanci dhe mburojë për ruajtjen e ekzistencës së trevës së Dibrës edhe si territor, edhe si etni kulturore e historike nga kërcënimi për asgjësimin e tyre që do t'u vinte nga përmbytja e Pellgut të Dibrës nga një liqen që do të krijohej më pas, si rezultat i një projekti të përfolur me emrin HEC-i i Skavicës.

Pas ndërtimit të Rrugës së Arbërit, populli i Dibrës nuk do të kishte nevojë për t'u shpërngulur masivisht, siç ka ndodhur këto dy dekadat e fundit, por do të ndërgjegjësohet më mirë për të mos e lëshuar vendin dhe për të mos i falur trojet e tij qindravjeçare vetëm për "60 cent"të USD-së (60 lekë) m2 , siç e ka parashikuar kompania italiane apo qoftë duke e shumëzuar me 10 që mund të arrijë deri në 600 lekë të vjetra për m2 gjithë


Foto: B.Gurthi

Dibrën, në një kohë që në krahinat e tjera të vendit qeveria shqiptare e ka vlerësuar p.sh në Vlorë me 280 euro m2 (gazeta "Panorama", Nr. 1673, 25 maj 2007) pa bërë fjalë për Tiranën, ku vlerësohen në mijëra euro për m2 (edhe për dibranët trojet e veta mijëravjeçare janë Tiranë e shkuar Tiranës, përderisa ata nuk i kanëvënë në shitje trojet e tyre).

Në rast se do të bëhet liqeni i Skavicës, do të përmbyste gjithë pellgun e Dibrës, duke zhdukur njëherë e përgjithmonë gjithë historinë dhe kulturën mijëravjeçare të Dibrës, në një kohë kur vetëm me resurset që ofron vetë treva e Dibrës, pa e përmbytur fare Dibrën, i shtohet ekonomisë kombëtare të vendit aq energji sa i ofrohet nga projekti që kemi parë e dëgjuar për HEC-in e Skavicës të ofruar nga një kompani italiane TGT.

Siç dihet, historia e një kombi përbëhet nga historia e gjithë trevave të tij, sigurisht duke marrë ato ngjarje më kulmore të kohëve të ndryshme në epoka të caktuara. Është e natyrshme se historia e jo të gjitha krahinave apo e jo të gjitha kohërave përfshihet në historinë kombëtare të vendit, por, kur është fjala për historinë e Shqipërisë, ajo kurrsesi nuk është e plotë pa historinë e Dibrës. Prandaj me çdo kusht duhet ruajtur historia dhe kultura e Dibrës, Por, siç dihet, çdo histori e kulturë zhvillohen në një terren të caktuar. Nëse do të zhduknim truallin në të cilin është zhvilluar një kulturë e histori e caktuar, sigurisht që do të zhduket edhe historia përkatëse e atij vendi. Prandaj, me çdo kusht, duhet ruajtur trualli i pellgut të Dibrës nga asgjësimi i saj prej çfarëdolloj mënyre, qoftë nga përmbytja prej uji apo prej shpërnguljeve masive etj. Përndryshe, do të zhdukej historia dhe kultura mijëravjeçare e Dibrës. Shembulli më i freskët dhe më tipik në këtë aspekt:

Përveç kohës së luftës së klasave, kohë kur nuk mund të flitej lirisht në mexhelis, edhe sot, shpërngulja e popullsisë nga treva e Dibrës, janë ndër shkaqet kryesore që po zhduket e folmja tipike e Dibrës, e quajtur "alegoria dibrane", e cila, në fakt, është shkolla filozofike e Dibrës prej mijëra vjetësh, shkollë kjo edhe pse pa shkrim, pa librat përkatëse, por është ruajtur e gjallë deri në ditët tona duke u transmetuar gojarisht brez pas brezi në mexheliset e odave dibrane.

Nuk do të thyenim asnjë tabu, në qoftë se themi se kjo shkollë filozofike e odave të Dibrës mund të jetë edhe paraprijëse e filozofisë së Ezopit të Greqisë së lashtë, përderisa shumë nga dijetarët dhe heronjtë e Greqisë së lashtë, përfshirë këtu edhe Akilin e "Iliadës" së Homerit, si dhe vetë Homerin, autorin e asaj poeme, është vërtetuar nga historianët se ata kanë qenë ilirë të mirëfilltë ose me origjinë ilire. Ndaj, për këtë, nuk është për t'u çuditur kur thamë se shkolla filozofike e odave të Dibrës mund të jetë i vetmi relikt i gjallë i shkollave filozofike të lashtësisë, përderisa historianë dhe gjuhëtarë të huaj dhe shqiptarë, e kanë vërtetuar se ne, shqiptarët, (d.m.th të parët tanë, ilirët apo pellazgët) jemi të vendosur këtu në Evropë shumë kohë më parë se grekët e lashtë dhe latinët.

Prandaj, duke përfunduar, shprehim mendimin se ndërtimi i Rrugës së Arbërit, duke i dhënë një hop të ri zhvillimit historik e kulturor të atyre trevave, do të japë një kontribut edhe në këtë aspekt, duke ndërgjegjësuar më shumë popullin e trevës së Dibrës për të qëndruar në atë vend, duke ruajtur kështu edhe trashëgiminë kulturore dhe historike mijëravjeçare të Dibrës.

Diskutimi nuk u lexua në kuvend, për arsye kohe, dhe u dorëzua nga autori në Sekretarinë e Kuvendit. Për këtë arsye po e botojmë për t'u njohur nga publiku.



Një Lobing për Rrugën e Arbërit

Nga XHAFER SEITI
Prefekt i Dibrës

Ka ardhur koha për të pasur tanimë një Lobing veprues që të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, të nxisë qeverinë dhe deputetët, të sensibilizojë opinionin, që edhe ai të bëhet pjesë e kërkesës

Më lejoni të shpreh sinqerisht vlerë simin tim për këtë takim, falënderimin për iniciuesit, për vlerën që ka rrahja e mendimeve dhe parashtrimi i ideve më të avancuara jo vetëm për rëndësinë e ndërtimit të Rrugës së Dibrës, quajtur ndryshe "Rruga e Arbërit", për rajonin e Dibrës dhe më gjerë, gjë që tashmë dihet, por më tepër për planifikimin e hapave konkretë në kohën e duhur për të trokitur në dyert që mund të hapin dritën jeshile për këtë projekt madhështor e jetik.

"Rruga e Arbërit", një histori e lashtë e një rruge të rrahur nga karvanet, si rruga më e shkurtër dhe e leverdishme, që lidhte Dibrën me Tiranën e përdorur deri vonë, përcaktuar nga mendja e ndritur e banorëve të kësaj treve, ndonëse jo me arsimimin apo njohuritë e sotme shkencore dhe me këto arritje teknologjike.

Kjo rrugë e ka aksin e vet, ka resurset e veta ndërtuese, është zgjedhur para shumë shekujsh nga vetë populli dhe ndoshta ka ardhur koha t'i shërbejë cilësisht këtij populli, tanimë e ndërtuar me parametra modernë.

Me të marrë detyrën e Prefektit të Qarkut Dibër më 7 ttor 2005 kam kërkuar nga të gjithë sektorët informacion me shkrim për punën e bërë gjatë nëntëmujorit janar-shtator 2005, jam njohur me të gjithë vjetarët statistikorë në vite, kam kërkuar informacion të hollësishëm për investimet në rajon, të ndara sipas sektorëve, njëkohësisht jam njohur dhe me prioritetet që kishin përcaktuar Organet e Qeverisjes Vendore dhe Institucionet Qendrore në Nivel Vendor.

Duke vlerësuar nevojën për investime në qarkun e Dibrës, duke qenë i prirur të mendoj se krahas asaj që ishte bërë në këtë qark për shumë faktorë, Dibra, Mati e Bulqiza në gjykimin tim meritonin më shumë vëmendje për vetë kushtet natyrore të infrastrukturës dhe ato klimaterike, kërkova që të hartohet një plan i detajuar prioritetesh për t'i analizuar në Organin Këshillues të Prefektit, organ ky këshillimor që nxit e bind Prefektin të nxjerrë urdhra të natyrave të ndryshme të zbatueshëm, në Rajon, kur ai e gjykon një gjë të tillë në shërbim të përmirësimit të punës.

Organi Këshillues i Prefektit, pas diskutimeve e argumenteve të hollësishme, të artikuluara e parashtruara në punime të ndryshme e në media nga Ju që jeni pjesëmarrës në këtë auditor, në mbledhjen e muajit dhjetor 2005, rekomandoi për Prefektin si prioritet të parë për qarkun e Dibrës: "Ndërtimin e Rrugës së Arbërit" dhe unë i bindur për domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, e kam përcjellë këtë rekomandim në Këshillin e Ministrave, Ministritë përkatëse dhe për gjithë deputetët që kam menduar se e kanë një lidhje me këtë qark, duke e renditur në vendin e parë të prioriteteve dhe duke u përqëndruar pikërisht në ato argumenta që studiues brenda radhëve tuaja, kanë renditur si elementë që rrisin domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge. Njëkohësisht për vetë natyrën dhe mundësitë që më jep detyra ime, këtë problem e kam diskutuar me gjithë të huajt me të cilët jam takuar, duke gjetur mundësitë të dal te tema e bisedës natyrshëm, të bind bashkëbiseduesin apo bashkëbiseduesit për rëndësinë e kësaj vepre, të qartësoj se nuk po e përdor si shtesë apo "xhep" të axhendës së bisedimeve, por një konsideratë prioritare të punës sime.

Për të artësuar edhe ndonjë keqkuptim, për të mos e quajtur dashakeqësi të ndonjërit, se e tillë nuk më pëlqen, pasi një e metë e këtij lloji nuk është në karakterin tim e nuk dua të jetë as te të tjerët, unë si Prefekt, përfaqësues i qeverisë në qark, në rastin konkret absolutisht nuk kam dashur e as nuk dua të marr meritat e askujt, por kam paraqitur të sistemuar, natyrisht shkurt, aq sa mund të mendosh të marrësh nga koha e limituar e Kryeministrit, atë që keni bërë ju, për të nxitur të bëhet ajo për të cilën ka nevojë komuniteti, që është punë konkrete, investim konkret, realizim të ëndrrës për të kapur Tiranën sa më shpejt, pasi hallexhiu do t'i zgjidhet halli e nuk do të dijë se kush ka bërë tema e studime apo të cilat prej tyre janë më të mira, më të sakta apo më shkencore.

Dhe kjo është bërë plotësisht brenda kornizave ligjore dhe atyre kompetencave që ka prefekti për t'i sugjeruar qeverisë, pjesë e së cilës është, se ku çalon më shumë puna e ku duhet ndërhyrë më shpejt.

Pa u zgjatur mendoj se ka ardhur koha për të pasur tanimë një Lobing veprues që të nxisë të gjithë aktorët dhe faktorët, të nxisë qeverinë dhe deputetët, të sensibilizojë opinionin, që edhe ai të bëhet pjesë e kërkesës. Kur ndërton thjesht një shtëpi ka vlerë qoftë dhe një gur i vënë në themelet e saj nga persona të caktuar e jo më kur mendon të ndërtosh një rrugë të tillë me aq vlera për të gjithë.

Unë si Prefekt, duke i qëndruar fort asaj që kam thënë dhe publikisht se populli i Rajonit të Dibrës para se të mendojë për të shkuar në Evropë, duhet të lidhet më shpejt me Tiranën, kam qenë dhe jam krah jush, krah të gjithë dibranëve, matjanëve e bulqizakëve, i gatshëm të jap dhe në të ardhmen ndihmën time modeste.

Ka ardhur koha për veprime konkrete dhe më mirë se ky auditor nuk ka se kush t'i përcaktojë se cilat janë ato, e radha që duhet ndjekur.

Nuk po kërkojmë të realizojmë trille teknologjike, por një rrugë!

Nga HYSEN UKA

"Ne nuk po kërkojmë të realizojmë trille teknologjike, por një rrugë, vetëm një rrugë, pa të cilën ato anë të vendit tonë, (Arbërisë) dita-ditës po zhbëhen. Shqipëria është aq e vogël, sa nuk ka as një pëllëmbë për ta braktisur"

Prania e kaq shumë dibranëve në këtë konferencë dhe shkalla e lartë e organizimit të saj, është ngazëlluese dhe na bën të jemi besimplotë, se së shpejti jo vetëm rruga e Arbërit, por djemtë e zot e të talentuar të Dibrës sonë, do t'i hapin Dibrës e Atdheut edhe plotë rrugë e perspektiva të tjera të ndritura. Ky projekt është ngritur në këtë stad të lartë, vetëm si rezultat i vetëdijes civile, shpirtit ndërtues e integrues që e karakterizon komunitetin tonë dibran. Ne të gjithë së bashku, e ngjallëm dhe nuk e lamë të vdiste rruga jonë. Ne të gjithë së bashku, e ndërtuam njëherë në mendje e zemër Rrugën e Arbërit, dhe tashmë do të provojmë, po të gjithë së bashku, se ashtu si kemi ndërtuar për të gjithë Shqipërinë, do të dimë të ndërtojmë shumë shpejt edhe rrugën tonë, Rrugën e Arbërit. Ne, të gjithë së bashku, do ta shkrijmë trombozën, atë gjakun e mpiksur që ka bllokuar këtë arterie jetike për shpirtin e Arbëri, këtë thelb të vetëdijes kombëtare, do ta nxjerrim nga harresa dhe do të bëjmë që e ardhmja jonë, që prej dhjetëra vitesh pritje, në startin e kësaj rruge të fluturojë drejt nesh, mes për mes Arbërisë...

Nuk e meritojmë ne dibranët që në kohët moderne, kur shoqëria po realizon trafikun ndërplanetar, ne të vijmë vërdallë nëpër gjysmën e Shqipërisë, shpat më shpatë e qafë më qafë, si të jemi çeta komitësh, nëpër një rrugë të stërzgjatur, më se dyfishin e normales, në inventarin e teknologjisë së ndërtimit të së cilës, shënohen vetëm kazma, lopata, dinamit dhe karroca druri.

Ne nuk po kërkojmë të realizojmë trille teknologjike, por një rrugë, vetëm një rrugë, pa të cilën ato anë të vendit tonë, (Arbërisë) dita-ditës po zhbëhen. Shqipëria është aq e vogël, sa nuk ka as një pëllëmbë për ta braktisur.

Nuk kemi pse të presim më të dëshpëruar ....

Rruga është pjesa më e qenësishme e **lirisë sonë.** Pa këtë rrugë, ne kurrë nuk mund t'i gëzojmë ato liri që bënë Europën e sotme, liri e lëvizjes së njerëzve, shërbimeve, mallrave dhe kapitaleve...

Pse duhet kjo, dhe si do të realizohet e thanë me kompetencë, të nderuarit referues, por unë do të desha të parashtroj disa mendime, me dëshirën që t'i shërbenin sadopak përpjekjeve tona në të ardhmen për zhvillimin e rajoneve tona:

Propozoj që konferenca si vullnet e dëshirë për bashkëpunim i të gjitha shoqatave e faktorëve dibrane, të krijojë një **Forum të Nxitjes së Investimeve për Dibrën (FNID)**. Emërimin dhe pagëzimin përfundimtarë këtij organizmi ja bënë konferenca. Qëllimi dhe funksionimi i Forumit, të rregullohet me akte normative që i miraton konferenca.

Ky Forum të përbëhet nga specialistë të niveleve të larta, të fushave të ndryshme, të financave dhe të ekonomisë, të inxhinierisë dhe ndërtimtarisë, ekspert të proceseve të integrimit rajonal e europian, ekspertë të menaxhimit të resurseve, vizionarë që kanë promovuar me sukses ide të tyre origjinale dhe administrator të suksesshëm, brenda e jashtë vendit.

Në dispozicion të këtij Forumi, duke filluar nga kjo konferencë me kontributet tona vullnetare, të hapet një llogari bankare. Fondet që do të mbushin këtë llogari do të administrohen, vihen në lëvizje, do të orientohen dhe kontrollohen nga një bord i Forumit. Forumi të ndërtojë lidhje dhe të gjejë modalitete bashkëpunimi me organizma ndërkombëtare, europiane të financave si: BERZH dhe BEI, diaspora, etj.

Bota financiare për të vetëdijshmit, qëllimmirët dhe të zotët është një lumë financimi i pashtershëm.

Unë kam emra që mund ti propozoj për në forum, por ende nuk e kam këtë të drejt.

Të shndërrojmë në një aktivitet tradite takimet e përvitshme "Ditët e Arbërit". Ditët e Arbërit do të jenë disa ditë takimesh, të të gjithë atyre që e ndjenë vetën arbërorë, kudo që janë që nga arbëreshët e Italisë, emigracioni i të gjitha brezave, në Amerikë apo Europë, të rinj e banorë të Tiranës, Dibrës e rajoneve të tjera që përshkohen nga Rruga e Arbërit. Këto ditë mund të caktohen në një nga muajt e verës apo ditë që lidhet me një datë historike të shtetit të Arbërit.

Çdo vonesë e ndërtimit të kësaj rruge shton agoninë e të ardhmes sonë

Përshëndetje e z. Shpëtim Cami,
Kryetar i SH. Q. "Votra Dibrane", Dibër e Madhe

Duke i uruar punë të mbarë Kuvendit Tekniko-Shkencor për "Rrugën e Arbërit", njëkohësisht shprehim keqardhjen tonë që, për shkaqe objektive, nuk kemi mundësi të marrim pjesë.

Aktivitetet dhe angazhimet e shumë subjekteve deri më tani, na bëjnë të besojmë fuqishëm, se ka ardhur koha dhe, se janë plotësuar kushtet për ndërtimin edhe të kësaj rruge me rëndësi jetike për banorët dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm edhe të këtij rajoni të vendit dhe me gjerë.

Qeveria paraprake me mjete te shtetit përgatiti programin e studimit të fizibilitetit dhe projektin ideor të ndërtimit të kësaj rruge, dhe se me vendim të Këshillit të Ministrave e aprovoi atë duke e futur në planprogramin nacional të rrugëve me përparësi të ndërtimit, kurse nga qeveria aktuale po kontribuohet në sigurimin e mjeteve për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge brenda mandatit të kësaj qeverie.

Çdo vonesë e ndërtimit të kësaj rruge shton agoninë e të ardhmes sonë.

Shqiptarët nuk kanë më kohë për të humbur me improvizime dhe eksperimente. Rruga e vetme është që të ndjekim eksperiencat e më të përparuarve dhe të shumëfishojmë angazhimet tona.

Me këtë rast, veçmas përshëndesim formimin e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" në Tiranë, duke dëshiruar suksese në aktivitetet e ardhshme.

Kronikë e një greve të paralajmëruar

1 qershor 2007

Minatorët e minierës së kromit në Bulqizë kanë ndërprerë punën, në shenjë proteste ndaj administratorëve të saj. Minatorët, përveçse kanë bllokuar punën në galeri, të grumbulluar në sheshin dhe hyrjen e kësaj miniere, kanë bllokuar edhe makinat e transportit të kromit, të cilat për orë të tëra kanë qëndruar në pritje të zhbllokimit të situatës. Shkak i kësaj proteste të paralajmëruar janë bërë pagat e ulëta që minatorët marrin prej vitesh, për punën në këtë minierë. Aktualisht, paga mesatare e një minatori, shkon në 25000 lekë, kur dihet se vështirësitë e punës së minatorëve, që punojnë në 1500 metra thellësi të nëntokës, janë disa herë më të mëdha se çdo punë tjetër. Sipas këtyre minatorëve, që me privatizimin e minierës nga firma italiane, Darfo, para 6 viteve, për ta nuk është bërë asnjë rritje page. "Kjo është e papranueshme, pasi koniunktura aktuale ndërkombëtare e çmimit të kromit është rritur së tepërmi, ku aktualisht një ton krom shitet në këto tregje me 220 dollarë, vlerë e paparë ndonjëherë gjatë gjithë këtyre viteve", thonë ata.



KËRKESAT E MINATOREVE

- **Të rritet me 50 për qind paga e çdo minatori**
- **Firma të kryejë investimet e parashikuara në kontratë dhe ta japë datën e saktë, kur do të fillojnë ato**
- **Të krijohen kushte më të mira pune**
- **Të nënshkruhen kontrata individuale dhe kolektive pune**
- **Raportet mjekësore të paguhen brenda firmës**
- **Të konfirmohet derdhja e sigurimeve shoqërore brenda muajit**
- **Të largohet sindikata ekzistuese dhe të zgjidhet një sindikatë e re nga punëtorët**

4 QERSHOR 2007

Greva e minatorëve në Bulqizë ka hyrë në ditën e katërt të saj. Nuk është bërë asnjë përpjekje e drejtpërdrejtë nga firma koncesionare, për të dialoguar me minatorët protestues. Minatorët kanë marrë edhe një kërcënim për pushim nga puna, nëse deri të hënën nuk do të rikthehen në galeri. Por ky kërcënim ka shkaktuar një reagim të kundërt nga ai që pritej, duke e ndezur edhe më tej protestën e grevistëve. Dilaver Përkoxha thotë së "qëndrimi i minatorëve mbetet i palëkundur për ta çuar protestën deri në fund".

6 QERSHOR 2007

Deklaratat e kreut të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) kanë irrituar së tepërmi minatorët. Të fyer nga ajo që ata e quajnë "tradhti" e njeriut që duhet t'i përfaqësonte, minatorët grevistë kanë deklaruar se do t'i djegin makinën Gëzim Kalasë, nëse ai guxon sërish të shkojë te grevistët në hyrje të minierës së kromit. Sot pritet ardhja e administratorit të firmës për të dialoguar me minatorët mbi kërkesat ekonomike të tyre. Gëzim Kalaja u ka thënë minatorëve të rifillonim punën, se përndryshe firma e huaj do t'i pushonte nga puna. Në një intervistë në televizionin lokal, Gëzim Kalaja u ka bërë thirrje minatorëve të ndalin grevën, duke i quajtur të parealizueshme kresat e tyre. Më 5 qershor, rreth orës 15:00, përfaqësia e grupit e përbërë nga Dilaver Përkoxha, Njazi Alliu dhe Zaim Hysa, u mor në polici për rreth 1 orë.

7 QERSHOR 2007

Negociatat e zhvilluara midis 650 minatorëve me përfaqësuesit e firmës së huaj që kanë marrë me koncesion minierën e kromit, kanë dështuar. Pas më shumë se 8 orësh bisedime, në prani edhe të kryesindikalistit Gëzim Kalaja, minatorët nuk kanë rënë dakord me ofertën e firmës së huaj ruso-austriake (DECO-METAL DCM & ICT), për rritjen me 15 për qind të pagës. Përfaqësia e minatorëve, në këtë takim ka vënë si kusht të vetëm për rifillimin e punës, rritjen e pagës së tyre me 100 për qind. Përfaqësia e minatorëve protestueskanë kundërshtuar me forcë propozimin e firmës së huaj, të cilët kanë premtuar gjithashtu se deri në fund të vitit, rritja e pagës së minatorëve do të shkojë 50 për qind. Por, edhe ky premtim është kundërshtuar nga minatorët, të cilët kanë deklaruar se nëse paga nuk rritet 100 për qind brenda pak ditëve, atëherë ata nuk do të futen më në minierë për të punuar. Sipas firmës, ndërprerja e punës nga minatorët është konsideruar e jashtëligjshme, edhe pse nuk jepen argumente për këtë paligjshmëri të saj. Përveç largimit nga puna, firma i kërcënon protestuesit se do t'i drejtohet gjykatës, për shlyerjen e dëmit ekonomik, që, sipas saj, minatorët i kanë shkaktuar kësaj firme, duke ndërprerë punën për më shumë se një javë. Firma ka deklaruar gjithashtu, se nga ndërprerja e punës janë krijuar mjaft probleme për minierën, si për ruajtjen e sigurisë teknike, ashtu edhe për dëmin e konsiderueshëm ekonomik.

11 QERSHOR 2007

Një aksident i rëndë ka ndodhur në minierën e kromit në Bulqizë, si pasojë e të cilit kanë humbur jetën dy minatorë. Nga shpërthimi i pakontrolluar i minave, në ballin e galerisë A1 në nivelin e pestë, humbën jetën minatorët, Avni Duriçi, 52 vjeç dhe Cen Lezi, 35 vjeç.

Avni Duriçi dhe Cen Lezi u paraqitën në minierë dhe filluan punën rregullisht. Ata ishin pjesë e një grupi prej dhjetë minatorësh, që u futën në thellësinë 2 mijë metra nën tokë, për të punuar. Rreth orës 13:30 minuta, gjatë shpërthimit të pa pritur të minave, janë aksidentuar me vdekje të menjëhershme, dy minatorët. Personi i tretë, që ruante hyrjen e galerisë, Qerim Lila, pjesëtar i këtij grupi pune, ka lajmëruar menjëherë për aksidentin dhe ka qenë minatori Shefki Alla, që ka shkuar menjëherë në vendngjarje dhe i ka gjetur pa shenja jete të dy të aksidentuarit.

Pasi ka ardhur grupi i ekspertizës nga qyteti i Peshkopisë, i cili ka këqyrur dhe kryer veprimet e duhura procedurale, reparti i avoro-shpëtimit të minierës, ka bërë nxjerrjen e trupave të viktimave dhe dërgimin e tyre në spitalin e Bulqizës, ku është bërë ekspertiza mjeko-ligjore e tyre, nga një grup i caktuar ekspertësh, në përbërje të së cilit ka pasur edhe hetues të policisë gjyqësore. Në mbrëmje, në shoqërimin e familjarëve dhe minatorëve, trupat e pajetë janë dërguar pranë familjeve të tyre.

Policia e Bulqizës tha se nuk dihen ende shkaqet e vërteta të këtij aksidenti të rëndë. Por shumë minatorë mendojnë se shkak i shpërthimit të parakohshëm të minave ka qenë cilësia e dobët e fitilave ndezës.

Spitali i Bulqizës nuk ka mundur t'u shkojë në ndihmë dje minatorëve të aksidentuar në një galeri dymijë metra nën tokë. Sipas burimeve nga spitali i qytetit, autoambulanca e vetme nuk ishte në gatishmëri, pasi nuk kishte karburant. Por mjekët thonë se minatorët kishin vdekur në vend dhe nuk mund të ndihmoheshin.

12 QERSHOR 2007

Janë përcjellë dje për në banesën e fundit nga familjarët, të afërmit dhe shokët e tyre, dy minatorët e vrarë në galeritë e thella të nëntokës, nga shpërthimi i minave. Kortezhi i përmortshëm është shoqëruar gjithashtu edhe nga deputetët e zonës, Sali Shehu dhe Genci Sharku, si dhe ai i Burrelit, Qemal Minxhozi. Përpara këtij funerali të jashtëzakonshëm për nga pjesëmarrja, minatorët e minierës së kromit kanë marshuar nga porta e hyrjes së minierës drejt bulevardit të qytetit. Ata kanë marshuar në rrugët e qytetit me dy kurora me lule, në shenjë respekti e nderimi për shokët e tyre, që humbën jetën aksidentalisht në minierë nga shpërthimi i pa kontrolluar i minave.

Dilaver Përkoxha, tha se "për tragjedinë që ndodhi ne akuzojmë firmën për mungesën e kushteve të punës, por gjithashtu apelojmë që shteti, si nënshkrues i kontratës koncesionare, të ndërhyjë pranë firmës së huaj për plotësimin e këtyre kushteve, që të mos humbin më jetë të tjera prej nesh në këtë minierë, ku nuk po kryhet asnjë lloj investimi".

14 QERSHOR 2007

Dy javë nga fillimi i grevës, asnjë kërkesë e minatorëve të minierës së kromit në Bulqizë nuk është plotësuar. Por, pas ngjarjes tragjike të ndodhur më 11 qershor, kur humbën jetën dy minatorë, kanë ardhur sinjalet e para për një kompromis nga ana e firmës ruso-austriake që administron minierën.

Tragjedia e ndodhur në minierën e Bulqizës pak ditë më parë, ku humbën jetën dy minatorë, ka shkaktuar mjafte debate dhe në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, mes deputeteve të opozitës dhe atyre të mazhorancës. Deputeti i opozitës së majtë, Qemal Minxhozi, ka akuzuar qeverinë dhe kompaninë italiane "Darfo" për lënien plotësisht në harresë dhe në kushte të mjerueshme e me rroga minimale të minatorëve në këtë zonë. "Është e pamundur që një punëtor i thellësive të mëdha, që shkojnë deri në 1300 metra, të paguhet me një pagë qesharake prej 250 mijë lekësh të vjetra dhe kjo nuk ka ardhur vetvetiu, por ka ardhur si rezultat i neglizhencës, i mungesës së interesimit për të vënë në pozita pune dhe ligjore kompaninë italiane 'Darfo'" është shprehur deputeti Minxhozi.

15 QERSHOR 2007

Një përfaqësi e minatorëve takohen në Tiranë me dy përfaqësuesve të huaj të firmës ruso-austriake dhe dy shqiptarëve, që janë drejtori dhe administratori i minierës.Në takim kanë hyrë edhe kryetari dhe sekretari i sindikatës së minierës, Shukri Çupi dhe Afrim Disha, por minatorët nuk kanë pranuar që ata të konsiderohen palë në bisedime. Minatorët janë të vendosur të mos e rifillojnë punën, nëse pagat e tyre nuk rriten me të paktën 50 për qind, ndërsa administratorët e minierës betohen se nuk mund të përballojnë një rritje page më të madhe se 30 për qind, madje edhe këtë të ndarë në dy faza.

18 QERSHOR 2007

Greva e minatorëve të minierës së kromit në Bulqizë hyn sot në fazën e saj finale. 50 prej minatorëve që kanë ndërprerë punën që nga 1 qershori, janë regjistruar për të hyrë në grevë urie sot. Kryesia e grevës, e përbërë nga 20 minatorë të vjetër, bëri me dije se vendimi për të shkuar në grevë urie është marrë dy ditë më parë, pas dështimit të të gjitha tentativave për të arritur një marrëveshje me firmën ruso-austriake, e cila administron minierën.

Protestave të minatorëve të Bulqizës, u janë bashkangjitur edhe 70 metalurgë të ish-uzinës së Ferrokromit në Burrel. Edhe kjo uzinë, është privatizuar me koncesion nga firma italiane "Darfo". Por si në Elbasan, Bulqizë e kudo, "Darfo" ka falimentuar edhe në menaxhimin e kësaj uzine, duke lënë pa punë 150 metalurgë. Sipas kontratës së nënshkruar, firma u detyrohet 70 metalurgëve, që t'u paguajë edhe 12 paga të prapambetura, të cilat ajo nuk po i shlyen që prej më shumë se një viti.

19 QERSHOR 2007

Greva e urisë, është shtyrë për në ditët e ardhshme. Dhjetëra minatorë u grumbulluan në sheshin e qytetit, në pritje të fillimit të grevës së urisë, në pamundësi për të depërtuar në ambientet e minierës, të cilat ruheshin me roje të përforcuara. Kryetari i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Kolë Nikolli i ka ftuar minatorët për negociata të tjera me qevrinë."Greva e urisë, duhet shtyrë, pasi duhet të konsumohen të gjitha hapat, për të arritur tek ajo dhe çdo gjë duhet të drejtohet nga sindikata, të cilën këta minatorë, nuk e kanë pasur, pasi janë tradhtuar prej saj dhe Gëzim Kalasë".

(Vijon në faqen 7)

"VIKTIMAT E NËNTOKËS"

CEN LEZI, baba i tre fëmijëve, punonte prej 15 vjetësh në këtë minierë. Ai njihej si njeri punëtor dhe i komunikueshëm. Ceni 35-vjeçar filloi punën në galeri, edhe pse shokët e tij ishin në grevë. Një arsye që e ka detyruar atë të hyjë në galeri, ka qenë edhe nevoja tepër emergjente për para, pasi duhej të shlyente një kredi bankare. Ceni kishte blerë një shtëpi në Bulqizën e Re, për të cilën paguante prej kohësh këstet mujore, që nuk mund t'i siguronte përveçse me rrogën e tij.

AVNI DURIÇI, 52 vjeç, baba i dy fëmijëve, banor i lagjes "Duriçe" në qytetin e vjetër të Bulqizës, njihet nga shokët e tij si një nga më punëtorët dhe të kualifikuarit që punonte në minierë prej më shumë se 25 vjetësh. Minatorët tregojnë se ai ishte aq i lidhur me punën, sa nuk ka pranuar të dalë nga puna në minierë dhe të marrë trajtim të veçantë si shokët e tij, apo në pension të parakohshëm, edhe pse e kishte mbushur moshën. Minatori Bajram Bardhi, thotë se "Avniu ishte shumë punëtor dhe në një gjendje ekonomike mesatare. Norma e realizuar prej tij, gjithmonë tejkalohej, duke shkuar deri edhe në 300 për qind.

KRONIKË NGA DIBRA E MADHE

"FILLOI NDËRTIMI I RRUGËS 100"

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës duke folur para gazetarëve për aktivitetet e pushtetit vendor, deklaroi se,"në rrjedhim e sipër është realizimi i disa projekteve infrastrukturore. Investimi më i madh aktual është hapja e Rrugës 100, si mundësi reale për rregullimin e komunikacionit në komunën tonë, me cka do të mundësohet që automjetet e rënda të mos kalojnë më nëpër qendër të qytetit, ku shkaktonin vështirësi si për automjetet e lehta ashtu edhe për këmbësorët. Kjo rrugë, vazhdoi ai "është me gjerësi 39 m dhe me gjatësi 458 m. Do të ketë dy korsi me nga 6 m, me rrugica të posacme për ciklistë, për këmbësorë dhe do të ketë edhe trasenë e gjelbëruar. Kjo rrugë fillon nga ish kombinati i qilimave dhe kryqëzohet me rrugën që shkon për në Strugë dhe me rrugën "Beton" që con në Bllatë. Deri tani janë kryer punimet e dheut, kanalizimi i ujrave fekale dhe i ujrave atmosferike, tamponimi, ndërsa në vazhdim do të bëhet vendosja e kabllove elektrike dhe tubacionit të ujësjellësit. Në këtë projekt punohet me një intensitet të shtuar me objektiv që të kryhet shtruarja me pllaka e rrugicave për ciklistët, për këmbësorët dhe hapësira e gjelbër, ndërsa në muajin gusht pritet të kryhet edhe asfaltimi. Krahas ndërtimit të kësaj rruge kemi në plan të asfaltojmë edhe dy rrugë në kompleksin e lagjeve "Uraniku" dhe "Tylbe" si edhe rregullimin e parkut të ri. Sivjet do të shtrojmë afër 10 mijë metra katrorë trotuare me pllaka betoni në qytet dhe në fshatra. Vlera totale e këtyre punimeve arrin 1 milion euro dhe të gjitha këto punime jemi duke i kryer me mjetet e komunës, pasi që Ministria e Transporteve dhe Lidhjeve e Maqedonisë, jo vetëm që nuk ka miratuar asnjë nga projektet me të cilat kemi aplikuar, por është duke na frenuar edhe nëpërmjet planeve detale urbanistike", tha në fund Fida. **/ R.T**

AMBASADA HOLANDEZE DONON KULTURËN DIBRANE

Për ditët e kulturës dibrane, që do të mbahen prej 10 korrikut deri më 10 gusht, Ambasada e Holandës ka dhënë një fond për dy vite 2007 - 2008 nga 20 mijë euro. Këshilli i Komunës së Dibrës, në njërën nga seancat e veta të fundit vendosi që viti 2007 të shpallet vit i Kulturës dibrane, me tendencë që gjatë muajve të verës ky manifestim të bëhet tradicional. Sic informon përfaqësuesi i kabinetit të kryetarit të Dibrës, Ylli Mirzo për ditët e kulturës dibrane, që dotë mbahen prej 10 korrikut deri më 10 gusht. Ambasada e Holandës ka dhuruar për dy vite 2007/08 nga 20 mijë euro, ndërsa pjesën tjetër do ta mbulojë pushteti vendor dhe biznesi lokal, që ta arrijë shumën prej 50 mijë eurosh për realizimin e projektit në fjalë. Projekti, shton Mirzo parasheh aktivitete kulturore e sportive, muzikë, folklor, që do të realizohen nëpërmjet SHASH "Haki Stërmilli", SHKA "Dibra" dhe grupit folklorik të fshatit Zepisht, pastaj teatër, me mbajtjen e Edicionit të VI të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni", krijimtari letrare, koloni të piktorëve, Edicionin e VI-të "Portiku poetik", turne në futboll të vogël, turne në basketboll, ragatë ndërkombëtare në kanu dhe kajak, turne ndërkombëtar në karate, maratonë në not, shënimin e "Ditës së shalqirit", fushatë mediale, e kështu me radhë.

Panairi i Librit në Dibër

Në kuadër të karvanit të Lidhjes së Botuesve Shqiptarë në Maqedoni, në fillim të muajit në Qendrën Kulturore në Dibër, u hap panairi i librit shqip i cili zgjati tri ditë. Në këtë panair më me shumë se 5 mijë tituj librash të zhanreve të ndryshme morën pjesë 12 shtëpitë botuese, mes të cilave "Vatra", "Luma", "Cabej", "Brezi", "Kultura S.H.", "Idriz Seferi", shoqata edukative "Vllaznia" etj. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës me këtë rast, theksoi: "Ky panair mbahet me financim të pushtetit vendor dhe qëllimi ynë është që të shndrrohet në manifestim tradicional të librit shqip. Kjo mundëson që banorët dibranë të të gjithë moshave të mund të njihen drejtpërdrejt me botimet e reja në gjuhën shqipe pa pasur mundësi që të udhëtojnë nëpër qytetet e mëdha ku mbahen panairet e librit". Ndërkaq, Sevim Ameti, kryetar i Lidhjes së Botuesve Shqiptarë në Maqedoni, fillimisht falënderoi pushtetin vendor të Dibrës për mbështetjen e dhënë për organizimin e këtij panairi të librit shqip." Këtu dashamirët e librit shqip kanë mundësi të gjejnë botimet që nga mosha para shkollore e deri te të rriturit", shtoi Ahmeti. Panairi në fjalë ka zgjuar interesim të madh dhe ai vizitohet nga nxënësit, studentët dhe të moshuarit e Dibrës.

R.T

PUSHTETI VENDOR U DHUROI UNIFORMA ZJARRFIKËSVE

Argëtim Fida, kryetari i Komunës së Dibrës dhe Nizamedin Papraniku, kryesues i Këshillit të Komunës, vizituan dje selinë e Organizatës së zjarrfikësve në Dibër dhe në mënyrë solemne u dhuruan atyre uniforma që përbëheshin nga kapela profesionale, xhube, nga dy palë pantallona, dy këmisha, bluza, këpucë zjarrfikësh dhe 200 metra tubo uji zjarrfikësish, gjithsej ne vlerë prej 3 mijë eurosh. Këtu duhet shtuar edhe aparatin për prerjen e metalit në rast aksidentesh të ndryshme në vlerë prej 500 eurosh, të gjitha këto të financuara drejtpërdrejt nga buxheti i komunës. Siç deklaroi kryetari Argëtim Fida, ky aktivitet për pajisjen komplete të zjarrfikësve do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke marrë parasysh gjendjen e vështirë në të cilën ndodhet kjo organizatë e rëndësishme për ruajtjen e pasurisë së qytetarëve nga zjarri dhe fatkeqësitë e natyrshme natyrore, ndaj të cilës në të kaluarën askush nuk vente dorë. Ky është shembull i mirë që zjarrfikësit në Dibër të jenë gjithmonë në gatishmëri për t'u ballafaquar me shuarjen e zjarreve. **/ R.T**

Kronikë e një greve të paralajmëruar

(Vijon nga faqja 6)

21 QERSHOR 2007.

Deputeti Qemal Minxhozi ka kërkuar në Parlament interpelancë me Ministrin e Ekonomisë Gens Ruli. Ministri Ruli ka konfirmuar qëndrimin e qeverisë për të zgjidhur cështjen. Ai ka kërkuar ndihmën e deputetëve të Dibrës, pasi firma që po përgatitet të marrë në administrim minierën, ka planifikuar investime serioze në minierë. Ruli kërkoi nga deputetët dhe punëtorët që të mos përkrahin "njerëzit" që kërkojnë t'i bëjnë një dëm të madh minierës. Ai u bëri thirrje punëtorëve të kthehen në pune dhe se Qeveria do ta zgjidhë këtë cështje në favor të tyre.

22 QERSHOR 2007

Mitingu i së mërkurës, që mblodhi dhjetëra minatorë grevistë në qendër të qytetit të Bulqizës, pothuajse nuk ka sjellë asnjë zhvillim të ri. Në këtë miting proteste morën pjesë Presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, një përfaqësues i sindikatës së metalurgëve të Uzinës së Ferrokromit Burrel dhe një përfaqësues i lëvizjes "Mjaft". Dilaver Përkoxha, një nga përfaqësia e minatorëve, akuzoi firmën e huaj, se po ushtron dhunë mbi minatorët grevistë, duke i kërcënuar ata me largim nga puna, nëse nuk u rikthehen galerive të nëntokës. Kreu i Konfederatës së Sindikatave, pasi ka dështuar në realizimin e një takimi, që kishte premtuar të bënte me ministrin Ruli për zgjidhjen e problemit të minatorëve, ka bërë thirrje përsëri për zhvillim negociatash me qeverinë, duke zbehur kështu dukshëm përshkallëzimin e kësaj greve dhe duke e bërë krejt të mjegullt vazhdimësinë e mëtejshme të saj.

PAS 22 QERSHORIT...

Shpresojmë që të gjendet një zgjidhje...

Bimët zbukuruese janë bashkëudhëtare në jetë me njeriun

Këto ditë doli nga shtypi një libër i veçantë në llojin e tij. "Lulet e mia, kënaqësia juaj" me autor Dr Selman Mëziu. Gjelbërimi dhe zbukurimi i mjediseve, është një kërkesë gjithnjë në rritje, në sasi dhe cilsi. Janë dhjetra pallate, qindra shtëpi banimi në qytete e fshatra që ndërtohen çdo vit, të gjitha e kanë të nevojshëm e të domosdoshëm sistemimin e mjedisit ku ndodhen, pasi vetëm kështu u rriten vlerat e përdorimit. Natyrshëm kur sheh një shtëpi apo pallat banimi, krahas arkitekturës së ndërtesës tërheq vëmëndjen mjedisi përreth, sistemimi e gjelbërimi i tij.Gjelbërimi dhe lulet kanë vlera të mëdha estetike jo vetëm në mjediset publike, por edhe në ato shtëpiake, pasi krijojnë një gjendje shpirtërore e shëndetsore më të mirë.Mjedisi i bukur e me lule çlodh vështrimin, ndikon drejtpërdrejt në qarkullimin e gjakut, në qetësimin e sistemit nervor e për rrjedhojë në rritjen e rendimentit të punës.Këto mjedise janë burim frymëzimi për artistët e pse jo për këdo, edhe për njeriun e thjeshtë, si të thuash bëhet krijues, këndon e mediton, pra cilitdo i krijohet një gjendje relaksi. Aq më tepër, mjedise të tilla janë të pazëvendësueshme për fëmijët dhe të moshuarit.Bimët e sidomos lulet, janë mbrojtësit më të mirë të mjedisit.Ato pengojnë pluhurin, rrezatimin e fortë diellor, zhurmat.Pengojnë erërat e rregullojnë lagështirën, mbrojnë tokën dhe krijojnë mikroklima të përshtatshme për jetesë. Bimët zbukuruese janë bashkëudhëtare në jetë me njeriun . Ai ato i ka pranë, në shtëpi, në ditë pushimi e feste, në gëzime e fatkeqsi.Ja pra pse të gjithë duhet t'i njohim, të kujdesemi, t'i mbrojmë lulet e në përgjithsi bimët e gjelbra.Është ky motivi kryesor që e ka shtyrë Doktorin e shkencave Selman Mëziu të marrë përsipër përgaditjen e këtij libri dhe ta verë në shërbim të specialistëve, lulishtarëve e aq më tepër të amatorëve të panumurt dashamirës të luleve.Ky botim është rezultat i një veprimtarie mëse dhjetvjeçare në këtë fushë, i konsultuar edhe me literaturën dhe praktikat më të reja të kultivimit të luleve dhe arkitekturën e gjelbër në përgjithsi, gjë që i jep vlera të veçanta e bashkëkohore këtij libri. Përvojën e punës së autorit në një vend si Italia (e njohur për mrekullitë në gjelbërim dhe arkitekturën e mjedisit), lexuesi do të gjejë në këtë botim të paraqitur thjeshtë, saktë e kuptueshëm për të gjithë.Dashamirsit e natyrës, kultivuesit e luleve, gjelbëruesit e mjediseve në përgjithsi, tashmë kanë një mundësi më shumë për sukses në punën e tyre.Libri "Lulet e mia, kënaqsia juaj" ua mundëson atë.

Ing.Gjon Fierza

BËNI ABONIMIN TUAJ

Në mënyrë që gazeta "Rruga e Arbërit" të jetë sa më pranë lexuesit, redaksia njofton se vazhdojnë abonimet.

Abonimi vazhdon për periudhën **deri në Dhjetor 2007 dhe** kushton **50 lekë për numër.**

Abonimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: **Cel: 068 31 19 232** ose në numrat fiks **(04) 357 179; 233 283.**

Abonimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë **"Fleta XXI"**, pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. **tel: 0218 4233.**

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

Ju kujtojmë se nga numri 13-të e në vazhdim, çmimi i gazetës do të jetë 50 lekë. Bashkëpunimet për gazetën priten deri më datë 20 të cdo muaji.

DIBËR E MADHE

SUKSES I QENDRËS PËR DIAGNOSTIFIKIM TË KANCERIT "FLORINA (RUSI) MARKE"



Zbulimi i hershëm i kancerit në gji garanci për jetën

Qendra për Diagnostifikimin e Kancerit në Gji "FLORINA (RUSI) MARKE" në Dibër të Madhe, tashmë katër vite pas përurimit është duke funksionuar me shumë sukses.Ajo dita ditës është duke fituar respekt e popullaritet dhe u ndihmon femrave në zbulimin e diagnostifikimin e hershëm të kancerit në gji,që është e vetmja mundësi për mjekim të suksesshëm.

Ne ditë më parë vizituam këtë qendër dhe takuam Dr.Nino Vasev-Spec. për kancerin në gji në Spitalin shtetëror në Shkup,i cili me specializimin e ka kryer në SHBA dhe eksperiencës së tij të vyer ,e menaxhon këtë qendër për diagnostifikimin e kancerit në gji në Dibër të Madhe me kontrolle të rregullta.Ky specialist i nderuar për gazetën tonë, deklaroi se:"Unë këtë punë në Dibër e bëj në mënyrë vullnetare, për respekt të familjes Rusi e të dibranëve dhe për tu ardhur në ndihmë pacientëve që në këtë qendër vijnë të kërkojnë ndihmë dhe shpëtim.Kjo qendër është bërthamë e vogël e shërbimit onkologjik model shembullor në botë. Ky lloj i asociacioneve të vogla kancerologjik edhe në SHBA-të ka gjetur aplikim të madh, ku femrat edukohen për vetëkontroll dhe kontroll të rregullt mjekësor.Roli i këtyre ordinancave mbështetet në zbulimin dhe diagnostifikimin e hershëm të kancerit në gji te femrat,si mundësi për ta parandaluar dhe mjekuar atë.Familja Rusi këtë qendër diagnostifikimi në Dibër e ka pajisur me Eho dhe Manograf nga më të sofistikuarit,dhe me personel mjekësor ku shërbimet kryhen pa asnjë pagesë.Deri tani janë kryer afër 450 vizita dhe kontrolle. Në vitin 2006 dhe gjatë pesë muajve të vitit 2007 janë kryer 130 vizita, që kanë rezultuar me zbulimin e hershëm të fibroadinomeve-tumorbening te 60 femra,prej tyre 8 femra janë diagnostifikuar me kancer në gji. Disa nga këto paciente janë operuar me sukses dhe disa gjenden në terapi të rregullt me mundësi maksimale për tu shpëtuar jetën. Po të mos ishte bërë zbulimi dhe diagnostifikimi i hershëm i kësaj sëmundje, për këto femra që po trajtohen do të ishte fatale.Sipas rasteve pacientët pastaj rekomandohen për në klinikën kancerologjike në Shkup,për tu operuar dhe për t'iu nënshtruar hemoterapisë dhe kinoterapisë.Në këtë qendër diagnostifikimi në Dibër punojnë Sidika (Haxhiu) Qormemeti- mjeke ,Bashkim Cami-specialist për ehon dhe Kadrie Korumi-asistente që bën pranimin e pacientëve.

Siç na tha mjekja Sidika (Haxhiu) Qormemeti në kkudër të kësaj qendre në Dibër të Madhe janë mbajur shumë cikle ligjeratash që i kanë ndjekur disa qindra gra dibrane.Në këto takime është bërë sensibilizimi i nevojës së kontrolleve të hershme dhe i ngritjes së kulturës shëndetësore te femrat, për tu kontrolluar te mjeku sa herë që vërejnë edhe më të voglin sinjal në gji, që kjo sëmundje e rëndë të zbulohet dhe diagnostifikohet sa më heret, që është edhe garanci më e madhe për tu mjekuar dhe shëruar.

Qendra për Diagnostifikimin e Kancerit "FLORINA (RUSI) MARKE", është e vetmja e këtij lloji në Maqedoni dhe në Ballkan që ofron shërbime falas dhe me një aparaturë të sofistikuar që familja Rusi e ka sjellë nga SHBA-të. Ketu vijnë e vizitohen pacientë nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Ajo që është më e rëndësishme të arrihet, është që te femrat të flaket mentaliteti i gabuar dhe të zë vënd kultura për tu vizituar rregullisht sa herë që lind dyshimi për kancerin në gji.

Familja Rusi dhembjen e shndëroi në humanizëm

Njerëzit bujarë dhe zemërbardhë nuk flasin shumë,për ta flet vetë puna dhe sakrifica e tyre,për ta flet mirënjohja dhe falenderimi i heshtur por shumë domethënës e i fuqishëm i personave dhe familjeve,të cilëve ndihma nga të sipërpërmendurit ua ka ëmbëlsuar brengën që u ka shkaktuar jeta,duke u futur reze drite,gëzimi e shprese në zemrat e tyre të shqetësuara.

Këtyre njerëzve bëmirës u takon edhe familja e dibranoamerikanit Turhan Rusi sëbashku me familjet e djemve të tij Selim,Ilirjan dhe Beniamin Rusi,të cilët aktualisht jetojnë dhe punojnë në SHBA-të.

Në vitin 1970 Turhan Rusi mërgon në SHBA dhe plot nëntë vite sëbashku me bashkëshorten Lirije,me mund e djersë rrisin katër fëmijët.Më vonë me djemtë e tij themelon kompanitë e veta të ndërtimit dhe pas 34 viteve pune sistematike,tashmë konsiderohen dibranët më të suksesshëm me afarizëm



Turhan dhe Lirije Rusi me djemtë Salin, Ilirjanin e Benjamimin dhe vajzën Florinën

në SHBA,ndërsa Ilirjan Rusi është edhe veprimtar aktiv i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, organizatë që gëzon respekt te qeveria dhe administrata e SHBA-ve.

Bujaria,humanizmi dhe zemërgjerësia e familjes Rusi ka qenë e pranishme dhe është dëshmuar me ndihmat e dërguara edhe gjatë trazirave në vitin 1997 në Shqipëri,me ndihmat për luftëtarët e UÇK-së në Kosovë në vitin 1999, me ndihmat nëpërmjet Degës së SH.H. "El Hillal" gjatë qëndrimit të mijëra refugjatëve kosovarë në Dibër,dhe ndihmat konfidenciale që shumë familje dibrane i gëzojnë edhe sot e kësaj dite.

Megjithatë jeta nuk sjell vetëm suksese e gëzime,ajo ka edhe anën e saj të zezë e të kobshme, që edhe njërëzve bëmirës u shkaton pikëllim e dhembje.

Kështu ndodhi edhe me familjen Rusi,kur në qershor të vitit 2003, nga një sëmundje të rëndë ndëroi jetë Florina, bija dhe motra e tyre e vetme,e cila la pas bashkëshortin dhe tre fëmijët Adhurimin,Aritonin dhe Ademin.

Derisa Florina ballafaqohej plot optimizëm me sëmundjen e rëndë që ia mori jetën, prindërit dhe vëllezërit e saj me shuma të mëdha parashë ndihmonin institute të ndryshme në SHBA që punojnë vazhdimisht për luftimin e kancerit. Familja e Turhan Rusit dhe e djemve të tij, në shej respekti dhe dashurie për Florinën,për këtë bijë dhe motër të dashur,menjëherë pas vdekjes së saj në Nju Jork themeluan Shoqatën jopofitabile Fondacionin e Kancerit "FLORINA (RUSI) MARKE",e cila ka për qëllim grumbullimin e fondeve që u dedikohen instituteve dhe klinikave për diagnostifikimin dhe mjekimin e kancerit në SHBA.

Në muajin gusht,në ditëlindjen e të ndjerës Florina, duke filluar nga viti 2003,ky fondacion çdo vit organizon në Nju Jork lojën e golfit, në të cilën marrin pjesë personalitete të njohura nga jeta politike,shoqërore dhe e biznesit amerikan,të cilët me këtë rast japin shuma të konsiderueshme parashë,si kontribut i tyre vullnetar për këtë fondacion, të cilat më pas u akordohen instituteve dhe klinikave më meritore kundër kancerit.

Më 15 nëntor të vitit 2003 z.Turhan Rusi dhe djemtë e tij përuruan në Dibër Qendrën për Diagnostifikimin e Kancerit "FLORINA (RUSI) MARKE" me financim të drejtpërdrejtë të familjes Rusi.

Kjo Qendër për Diagnostifikimin e Kancerit tashmë ka filluar punën dhe është e pajisur me personel përkatës dhe me aparatet më të sofistikuara për zbulimin e kancerit në gji.

Vizitat,kontrollet mjekësore dhe ndihma që ofron personeli i specializuar mjekësor në Qendrën për Diagnostifikimin e Kancerit "FLORINA (RUSI) MARKE" në Dibër janë falas.Këtu mund të vijnë të vizitohen pacientë nga Dibra,Maqedonia,Shqipëria,Kosova dhe të gjitha shtetet përreth,pa marë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare e konfesionale.

Turhan e Lirie Rusi sëbashku me djemtë Selimin,Ilirjanin dhe Beniaminin me familjet e tyre,zgjodhën këtë mënyrë fisnike dhe humane, për ta mbajtur gjallë emrin e bijës dhe motrës së tyre Florinës, në shej kujtimi të pëtjetshëm,duke bërë përpjekje që fatin tragjik të bijës së tyre ta pësojnë sa më pak femra.

Kjo njëherit shpreh vullnetin dhe sakrificën e familjes Rusi,që dhembjen për bijën dhe motrën e tyre Florina, ta kthejnë në humanizëm.

Tani Florina edhe pse në botën e amshuar, ajo rezaton reze shprese gjithnjë për të ndihmuar njerëzit në rrezik për jetën.

Rexhep TORTE

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179 / 233 283
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Sarina 2002
Progras dijesh
Regjistrimet kanë filluar.
Tel: 068 20 37 865
(04) 357 605

Si e kujtoj patriotin Aqif Lleshi

Nga **SHKËLQIM SHEMSI HATIPI,**
Dibër e Madhe

Në vitin 1946, mbasi babai ishte i arratisur, nëna Meribane, unë dhe motra Seadeti erdhëm prej Tirane në Dibër te gjyshi dhe daja Bajrami – Haki Haxhirexha, prej rreziku se mos na internojnë në Shqipni si familje balliste.

Në atë kohë për ushqim dhe veshmbathje jepeshin triska (kupone).

Per familjen tonë, me sa më kujtohet, rreth 20 muajve nuk na jepnin triska. Mungesa e ushqimit ishte shumë e madhe dhe ndryshimi i çmimit shendrell të miellit të misrit me triska ishte 1 din, kurse në treg ilegal 100 din. Për këtë periudhë, saktësisht me 24.04.1947 e vranë babën, kështu që ne ngelëm përgjithmonë në Dibër.

Të ndjerët gjysh Bajrami dhe daja Hakiu nuk lejoshin që nëna Meribani të shkonte dhe të kërkonte prej organeve përkatëse triska për ushqim dhe veshmbathje.

Një natë e ndjera nënë më tha: A e mban mend zyrën ku e kishte yt atë? Unë ju përgjigja po. Atëherë nesër të marrësh leje në shkollë e të shkosh te kryetari i Këshillit të Rrethit, Aqif Lleshi dhe t'i thuash pse për ne nuk ka triska? Baba u vra , ne me çka të jetojmë dhe më porositi që askush të mos e dijë se ishe te kryetari (as në shtëpi , as në shkollë).

Ishte viti shkollor 1947-1948 dhe unë isha në klasë të parë gjimnaz (V), data s'më kujtohet, por disa ditë para pushimeve gjysvjetore.

Siç më porositi nëna, unë atë ditë shkova në shkollë dhe mbas orës së dytë mora leje dhe shkova në Këshillin e Rrethit. Rrugës mendoja si fëmijë, shkoj t'i lutem kundërshtarit politik të babës, por …….

Kur hypa shkallëve dhe u afrova te zyra e kryetarit që ishte pak hapur, kuriri (roja) më pyeti kë kërkon. I thashë kryetarin. Ai m'u përgjigj: "Ik more shejtan, shko në shtëpi, por në moment doli kryetari (Aqif Lleshi) dhe m'u drejtua: Kë kërkojsh me mixhën? Unë ju përgjigja: - Ju. Hymë brenda dhe ai u ul në karrigen e tij të punës dhe më tha edhe mua, ulu djalë dhe unë u ula.

Fjalën e parë që më pyeti ishte: I kujt je? Dhe mbasi i tregova, më tha se pse kam shkuar dhe unë ia tregova porosinë dhe fjalët që më kishte thënë nëna.

Meqë e njihte prejardhjen time familjare, më tha se nëna ime kishte djalë tezje Gani Grazhdanin, i cili ishte në atë kohë përgjegjës për shpërndarjen e triskave dhe më pyeti se pse ju ka lënë ju pa triska? Unë u përgjigja që nuk e di. Menjëherë me kuririn e thirri Llazo Topallosken, të cilit i tha pse nuk i kini dhënë këesaj familje triska? Ai ju përgjigj: A e dini se i kujt është?

Aqifi i zemëruar nxori pistoletën prej seku dhe i tha: Bir i shkinës, a duhet të vdesin këta? Dhe i dha urdhër që të shkoni shpejt dhe të thirret Gani Grazhdani dhe Qenan Rusin, të cilët erdhën shpejt dhe i pyetën se pse nuk na kanë dhanë triska. Ata heshtën, u urdhëruen që për të tre ne, për 20 muaj të bëjnë triskat gati shpejt.

Pastaj thirri Nezir Kocin dhe Muhamet Krifcen që kishte veshmbathjen dhe Sakip Damzin që ishte transportues me karrocë.

Mbasi erdhën të sipërpërmendurit, u tha që për ne të tre (familjen tonë) të përgatisin ushqim për 20 muaj dhe veshmbathje, në se nuk kini në dyqan të merrni prej Rezervave Shtetërore, të gjithë ju përgjigjën si të urdhërojë Aga Aqif.

Pastaj u tha distribuimin ta bëjnë mbasi të erret, natën, meqë Bajram Aga dhe i biri kanë sedër mos shohin të tjerët.

Ganiut i tha që sonte për darkë të shkosh te tezja tande e kur të vjen Sakipi me ushqimet e veshmbathjen, të thuash se unë i kam dërguar, mos e marrin vesh se ka qenë djali këtu tek unë dhe ashtu u veprua.

Para se të largohem unë, më pyeti se si jam me mësime. Unë i thashë shumë mirë, atëherë si të mbarosh progjimnazin të vish te unë të japim bursë, se dhe baba Shemsiu dhe i ati Vebiu kanë qenë të shkolluar dhe më tha tash je i lirë, shko në shkollë. Unë e falenderova. Ai më dha dorën dhe une u largova.

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179 / 233 283,** ose të na shkruani


në **E-mail: lid_gazeta@yahoo.com**

Me rastin e nje vjetorit të vdekjes së Dr.Lutfi Turkeshit

Në pranverë zhbëhen kujtimet për të

Nga ATLI DEMA

Njohur me qëmtimet e tija shkencore si në lëminë e gazetarisë apo asaj të historisë, për të cilën fitoi edhe titullin Doktor i Historiografisë së gazetarisë. Doktor Lutfi Turkeshi rreth katër decenie jeton me veprimtari intensive shkencore si në lëminë e publicistëkës poashtu edhe në lëminë e historisë. Rruga komplekse e kësaj veprimtarie bëri që doktor lutfi Turkeshi të botojë librat "Historia e shtypit shqiptar", "Penda për çështjen kombëtare", dhe "Kongresi i Dibrës", të cilat bënë që këtë rrugë ta vazhdojë me dinjitet, për të marë edhe titujt më të larta të publicistikës…



Lutfi Turkeshi

E gjthanshme është veprimtaria e tij patriotike, shkencore historike, publicistike, shpesh edhe analitike e gjurmuese, Doktor Lutfi Turkeshi punoi si gazetar në Radiotelevizionin e Shkupit dhe gjatë asaj periudhe qe një shprehës i fuqishëm i shqiptarizmës, në çdo periudhë të veprimtarisë së tij, ai ishte edhe organizator i aktiviteteve kulturore poashtu edhe drejtues i Klubit Letrar "Art Klub" të Dibrës. Doktor Lutfi Turkeshi duke gjurmuar veprimtarinë e gazetave në trojet shqiptare të Maqedonisë, ka bërë përpjekje për të ndriçuar rolin e tyre të madh në gjallërimin e lëvizjes kombëtare të kohës, sidomos të viteve 1908-1912.

Sipas Bardhosh Gaçes, Turkeshi kontributin e shtypit shqiptar në këtë kohë e jep në sfondin e tabllosë së gjërë të jetës politike, shoqërore, arsimore e kulturore, duke analizuar edhe ngjarje të rëndësishme historike, siç ishte ai i shpalljes së Kushtetutës së Hyrjetit (Lirisë), siç u quajt atëherë, ku intelektualët e gazetarët shqiptarë bënë përpjekje për fitimin e të drejtave kombëtare. Autori i librit "Penda për çështjen kombëtare", "Historia e shtypit shqiptar (1908-1912" me të drejtë zhvillimin e shtypit të asaj kohe e shikon si pjesë përbërëse të lëvizjes kulturore, zgjërimit të shkollave dhe botimeve të tjera në gjuhën shqipe, të cilat ndikuan drejtpërdrejtë në ritjen e ndërgjegjes kombëtare. Doktor Lutfi Turkeshi në botimet e tija interes të veçantë ka treguar për pasqyrimin në shtypin e kohës të kryengritjeve, shpalljes së pavarësisë, ku u shtruan dhe u zgjidhën një varg problemesh për çështjen kombëtare shqiptare.

Për peshën e shtypit shqiptar, Turkeshi shprehej se në momente të caktuara shtypi u bë zëdhënës i fjalës luftarake për të ngritur peshë shqiptarët në luftë kundër shteteve shoviniste të Ballkanit. Në faqet e librave të tij gjejnë vend edhe përshkrimet dhe analizat për personalitetet e shquara të shtypit, gazetarë, publicistë dhe drejtues të gazetave, gjen vend veprimtaria dhe kontributi i klubeve patriotike shqiptare të cilët kanë luajtur rol në gjallimin e lëvizjes kombëtare, ai në shkrimet e tija, problem qenësor ka shpalljen e pavarësisë, alfabetin e gjuhës shqipe, lufta për shkollat shqipe, pasqyrimi i kryengritjeve, anti turke e anti serbe, ku nëpër artikuj e kronika tregohej shpirti i tij liridashës.

Doktor Lutfi Turkeshi me pietet shkruajti në materialet në vazhdim (Fejtonet për pishtarët e kombit, Nënën Terezë, autorët e botimeve më të reja të cilat janë përmbledhur në veprat " Në rrjedhë" dhe "Hija e Fjalës, ai prirej për të shtruar profile letrare, si libri i botuar me reçensione, e vrojtime e ese të shkruara në intervale të ndryshme kohore të botuara në gazeta e revista shqiptare në Maqedoni, vepër e titulluar "Nga fjala në fjalë metaforë", ai në këtë vepër ka bë vrojtime të poetëve tanë për një ose më shumë libra duke u shprehur pjesërisht individualitetin e tyre krijues, të cilat dalin si impressione të nxjera nga veprat e lexuara dhe përmes vrojtimit të bashkojë ndjeshmërinë dhe gjykimin në favor të lexuesit.

Udha e krijimtarisë së Doktor Lutfi Turkeshit është e gjatë, por i përhershëm do të jetë udhëtimi i vlerave që krijoi, veprat e tij kanë hyrë në përditshmërin e njerëzve. Opusi i tij letrar e publicistik gjithmonë ka shtruar shpirtin e vet, mendjen dhe ndjenjat duke krijuar vepra me origjinalitet të lloit të vet.

E veçantë e tij është stili metaforik i të shkruarit, bagazhi i ngjeshur i togfjalëshit në stilin e rrugëtimit të kërkimit shpirtëror, saktësia e përshkrimit, figuracioni i mbushur sa një det me plot impulse filozofike apo siç shprehej ai me thënje të mendjeve të ndritura të kombit.

Doktor Lutfi Turkeshi në letrat shqipe meriton të mbajë shumë epitete artistike: gazetar e publicist, mjeshtër i metaforës dhe alegorisë, vrojtues e analitik, historian e kritik letrar, numri i krijimeve të tija të botuara si dhe materialet në dorëshkim që presin të botohen bënë që tja kenë lakminë shumë krijues nga mjediset tona krijuese shqiptare këtu në maqedoni e më gjërë.

Ate që thoshte ai për të tjerët do të shprehemi ne për të, se, artistët e mëdhenj janë pjesë e traditës që është biografia e kombit. Kombi ata i nderon, se nderon biografinë e tij, ai ishte ai gur, gur i rëndë i letrave shqipe.

Njeriu i kërkimit dhe kristalizimit të së vërtetës duke e njohur në skuta jetën bën komunikime intuitive që kurë nuk ndejti indiferent me letrat e tij, njeriu që një vjet nuk është prezent mes nesh, i cili në letrat shqipe hyri me nderim e përkushim, gjithmonë do të mbetet në oborin e krijuesit shqiptar.

Ëndra e guximshme e tij që me shkrime të jesh kudo, në radio, television, gazetë e revista si dhe në faqet e librave, bëri që veprimtarija e tij të ekzistojë dhe të kujtohet në vazhdimsi në pranverë për të zhbërë kohën e kujtimeve.

65 vjetori i Çetës së parë Partizane të Dibrës

Çeta Partizane e Dibrës u krijua me 20 qershor 1942, 65 vjet më parë, në Zogje të Dibrës, me vullnetarë dibranë dhe luftëtarë të ardhur nga Tirana, Korça etj. Komandant i Çetës së Dibrës u caktua Haxhi Lleshi, zv.komandant Dali Ndreu dhe komisar Qazim Prishtina nga Kosova.

Në formimin e Çetës së parë Partizane u rreshtuan 20 partizanë si: Nazmi Rushiti, Demir Gashi, Zoi Themeli, Xhavit Hatibi, Esat Ndreu, Irfan Hajrullai, Ejup Hatibi, Spiro Velko, Beshir Laçi, Musa Lala, Ali Pepa, Ilmi Çausholli, Ahmet Jegeni, Xheladin Krifca, Eshref Palikuqi, Ibrahim Kasapi, Demir Leka, Emin Agolli, Imer Lleshi, Pali Carapuli etj.

Deri në mars të vitit 1943, Çeta e Dibrës kishte 22 partizanë, ndërsa në qershor të vitit 1943 kishte 60 partizanë.

Në shkurt të vitit 1943 u krijua çeta partizane e Sllovës. Në mars të vitit 1943 çetat e Grykës së Madhe dhe Bulqizës. Ndërsa në maj të vitit 1943 u krijua Çeta e Gollobordës.

Më vonë, më 26 korrik të vitit 1943, në fshatin Gjoricë u krijua Batalioni Partizan i Dibrës, në përbërje të të cilit ishin çetat partizane të krijuara në Dibër.

Në ndihmë të forcave partizane, në rajonin e Dibrës u krijuan edhe çetat territoriale, me mbi 300 vullnetarë, të drejtuara nga patriotët: Aqif Lleshi, Beshir Sufa, Faik Shehu, Hajdar Shehu nga Bulqiza, Riza Novaku, Myslim Shehu nga Zerqani, Cen Puca nga Sopoti etj.

Krijimi i Çetës së parë Partizane të Dibrës në Zogje dhe çetave të tjera në të gjithë Dibrën ishin shkëndijat e para, që mobilizuan dhe ngritën në këmbë gjithë popullin e Dibrës në luftë kundër pushtuesve nazifashistë për çlirimin e vendit.

Xhelal Ndreu një talent i rrallë që u përvëlua në flakët e komunizmit

Nga NAIM PLAKU

Në vitin 1996 me kujdesin e familjes pa dritën e botimit një vepër e rrallë në llojin e vet dhe individualitetin artistik me autor Xhelal Ndreun. Në fillim, ashtu si çdo histori e veprave të mëdha, edhe përmbledhja modeste " S'ka qetësi në lisivalle" kaloi si pa u vënë re,por ndërkohë rritej gjithnjë e më shumë interesi për ta lexuar atë, ato pak poezi origjinale e përkthime dhe prozën e trajtuar si diçka e veçantë në pasqyrimin e një realiteti historik të përjetuar në Dibër. Lexuesi i vëmendshëm që në fillim e kupton se kemi të bëjmë me një talent të spikatur e të pjekur,me një krijues të përmasave të mëdha, poet e shkrimtar, përkthyes e publicist dhe se kjo është vetëm një pjesë fare e vogël nga veprat që shkroi gati për 40 vjet.

Kush qe Xhelal Ndreu? Nga vinte? Si u poq dhe pastaj.... si u shkermoq ky talent i letrave shqipe? Si u zhduk dhe ku mund të jetë vepra e tij madhore? Kush e zhduku dhe ku duhet kërkuar ajo? Këto dhe të tjera pyetje kanë shumë pikëçuditje pas që meritojnë një vëmendje të veçantë nga kritika jonë letrare. Padyshim që ai shkroi dhe përktheu të tjera vepra. Duhen përpjekje e mund për të kërkuar e gjetur të vërtetën,për të zbuluar krijimtarinë e tij ose për ti vënë gishtin varrmihësit, asgjësuesit e përvetësuesit të saj. Mjafton të lexojmë "S'ka qetësi në lisivadhe",poezitë, shqipërimet, dhe prozën e kësaj përmbledhjeje që të gjykojmë se kemi të bëjmë me një krijues me talent e me një vepër të pjekur . Xhelal Ndreu i përket atij brezi shkrimtarësh që tentuan të nxjerrin gjeth e lule në një pranverë të errët e pa diell, të përvëluar nga flakët e kuqe të komunizmit, që u mbeti në kthetrat e bishës dhe ato pak që shpëtuan janë të grisura e të çjerra që mbajnë njollat e një gjaku të pastër. Por duke gjykuar nga vepra që kemi në dorë themi me plot të drejtë se ai është e mbetet një shkrimtar i madh, një poet i talentuar, një përkthyes i përkryer dhe një publicist origjinal. Minareja nuk futet kurrë në thes e as lisi nuk pritet me një sopatë. Historia shpesh herë është treguar e pamëshirshme duke groposur në vorbullën e vet njerëz të shquar.Xhelali lindi në Sllovë të Dibrës më 1911 në familjen e njohur të Elez Isufit, djali i nacionalistit dhe patriotit të shquar Cen Elezi, që vdiq në rrethana misterioze nga torturat e UDB titiste në burgun e Shkupit, pasi kishte dalë malit me djemtë e ndiqej nga regjimi i Hoxhës .U përkund dhe u rrit në këtë vatër trimërore, në djepin e legjendave dhe të këngëve heroike, ku gjëmonte çdo mëngjez e mbrëmje thirrja e fuqishme "a besë-a-besë", që tundte male e ngrinte karakolle, që bashkonte malsorët në luftërat dhe qëndresën 9 vjeçare kundër shovinistëve serbe. Në këtë shtëpi u hap e para shkollë shqipe më 1914, ku më vonë mësoi dhe Xhelali nga mësues të nderuar si Haki Sharofi, Abdulla Çanga, Hafuz Tahiri, Hoxhë Kalla etj. Këtu qëndruan trimat e rezistencës antiserbe Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, etj. Këtu do të niste rezistenca antifashiste, këtu, në pragun e kësaj shtëpie do të derdhte gjakun në luftë me gjermanët patrioti Ismail Strazimiri, këtu do të vinin si në peligrinazh misionaret angleze Sibill Llojd, Margret Hozllak etj...

Ishte një fëmijë jo i zakontë për moshën dhe interesat për të mësuar gjithçka në një mjedis ku mbretëronte analfabetizmi. Kur mbushi 11 v jeç, i ati e dërgoj në shkollën amerikane " Harri Fulltz" në Tiranë, ku qe në fillim spikati dhe kaloi në vëmendjen e vetë drejtorit talenti i djalit dibran. Aftësia e tij e jashtëzakonshme u shfaq më tepër në interesin për të përvetësuar gjuhët e huaja. Fliste dhe shkruante shkëlqyeshëm anglisht. Pikërisht për këtë se ishte një nxënës i përkryer në të gjitha lëndët, drejtori Fulltz bëri një vizitë miqësore ne familjen e tij në Sllovë dhe përkthyes i bisedës së gjyshit të tij Elez Isufin me drejtorin ishte djali i vogël Xhelal. Por jo vetëm anglisht. Mbrenda vitëve të shkollës së mesme përvetësoj me kaq zell gjermanishten, frëngjishten dhe italishten, që së bashku me turqishten, arabishten e rusishtën që e mësoi në burg, do ta bënin një poliglot të vërtetë që ligjëronte aq bukur në shtatë gjuhë. E mbaroi shkollën me medaljen e artë dhe një bagazh të tërë njohurish gjuhësore e teknike. Shërbeu tre vjet si mësues në fshatin e tij, më vonë si sekretar gjykate në Dibër e Ostren. Shkoj për oficer në një shkollë që u hap në kohën e mbretit Zog dhe e pa të udhës të vazhdonte një kurs të plotë për kryetar komune ku punoi me devotshmëri në Shijak, Vlorë, Gramsh e Tepelenë. Si gjithë familja e tij, në fillim përqafuan idealet e luftës çlirimtare.Në këtë shtëpi u formua çeta partizane e Dibrës.Gjithë djemtë e vajzat e kësaj familje të madhe u rrjeshtuan në formacionet e luftës partizane.Kështu dhe Xhelali mori pjesë në brigadën e parë në luftën për çlirimin e Tiranës dhe ishte zëvëndës komandant batalioni.Gjatë luftës siç e tregojnë shumë dokumenta, misioni anglo-amerikan në Shqipëri e pati Xhelalin shoqërues dhe përkthyes që do shikohej me sy të keq e do ta kishte në shënjestrën e tij Enver Hoxha. Misionarët ushtarak perëndimor kanë dhënë vlersime dhe merita për Xhelalin, si një intelektual me horizont të gjërë, si personalitet dhe nacionalist i vendosur.Babai i tij Cen Elezi me një kontribut të gjërë në këtë luftë, u shfaq me bindje të theksuara nacionaliste dhe antikomuniste që në Mukje e më pas në Konferencën e Pezës, prandaj do të trajtohej si armik e të ndiqej nga Enver Hoxha deri sa gjeti vdekjen në burgun famëkeq të Shkupit nga torturat e shumta, ndërsa të gjithë djemtë dënohen me burgim maksimal e e tërë familja e madhe internohet në kampin e Lubonjës Vlorë, pasi enden në kampet ferr të diktaturës në Berat, Tepelenë, Kuçovë, Porto Palermo për gati një gjysmë shekulli.Xhelali dënohet me 20 vjet burg.Me një vullnet të jashtzakonshëm, me një përkushtim prej heroi iu vu punës edhe në kushtet më mizore që kishte burgu shfarosës i asaj kohe, të thellohej në përvetsimin e gjuhëve të huaja dhe të shkruante me aq sa mundej e të mbaronte disa vepra të nisura e ndonjë tjetër me frymëzimet që i sillte realiteti. Mësoi rusishten e frëngjishten, më vonë duke patur në krah përkthyesin e njohur Isuf Vrionin. Në burg shkroi poezi, romane, drama, monografi, tregime, përktheu nga veprat të mira të letërsisë botërore të cilat u zhdukën a u dogjën nga dora e zezë.Shumë flitet e përflitet për veprat e tij.Thonë se shumë nga ato ia pati dërguar siç ishin dorshkrim ish kryeministrit Mehmet Shehu me shpresën e një premtimi lajkatar se do të gjente mundësinë për t'ia botuar. Kështu u zhdukën rreth 5000 faqe dorshkrime, disa romane, tregime e novella, 850 poezi origjinale. Xhelali është autor i romaneve "Huma',

"Karp Peron", i monografisë "Dibra", i shumë skicave, monografive, poezive,i mbledhjeve folklorike të krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Pasi del nga burgu i thyer e i sëmurë, i vihet punës për të sistemuar ato pak gjëra që i kishin mbetur nga krijimtaria e tij, por në vitin 1987 e arrestojnë përsëri, këtë radhë si nxënës të Fulltzit dhe vëlla me organizatorin e lëvizjes antikomuniste në diasporë, Isa Ndreun.Pas torturash dhe presioneve psikologjike, i dërmuar tërë jetën në burgjet komuniste, i ndarë nga familja dhe shoqëria, nuk mundi t'i rezistojë më kësaj kohe të egër e vdiq në Lubonjë të Vlorës më 6 tetor 1988.Vdekja dhe jeta e këtij njeriu ngjan me një yll vezullues në qiellin e letërsisë shqipe, që këputet nga yllësia e pamatë e gjithësisë. Por Xhelal Ndreu vërtet qe një yll vezullues ndaj shpresojmë që ta shohim dritën e veprës së tij. "S'ka qetsi në Lisivalle" është një perlë e vogël në gjerdanin e krijimtarisë së tij.

Nandë malet e Dibrës

Dhashë e dhashë që të mos kthehem ma në Dibër, por ma në fund mendova të kthehem, jo si përpara, por me kujtime. E malli e dashnia më shtynë që të kthehem si një kalimtar. Sado i molisun, mjegullat që më patën mbulue i davarita mbi fletët e laguna nga lot mallëngjimi. Nga vesa e muzgjeve dhe e agimeve, s'di sa herë me muaj e vjetë, iu përvesha punës të shpreh ato që ndiej tue kalue nëpër vendin tim. Dhe pena ime, nuk do të lajthitje apo të greshitje, ashtu si gjurmët e mia kryq e tërthor vendit tim, që e kam dashtë dhe e dua kaq shumë, do të më çojnë në çdo skaj e skutë, maleve e bjeshkëve, prrojnave , arave e fushave, pranë lumenjëve, shpate e luginave, ku i thonë vendit Dibër. Dhe nji që e don kaq shumë këtë vend, doemos i don edhe njerëzit që e banojnë. Pena ime nuk do të qendisje rruza e ojna, as bejte, por kujtime e ndodhina origjinale, pa shpresën e muzave e pa fantazina, do t'i rënditje pa leqe nëpër përgjellin e gjurmëve, ku t'ia çojnë mendimet dhe përgjërohem: Për ujnat e ftohtë të bjeshkëve, për ernat e freskëta të përhodos e Korabit, për valët e turbëllta të Drinit, për ujët e kulluet të Setës, për liqejt e kristaltë të Lurës, për aromën e luleshtrydheve të moraves e të Granabutit, për lupardhat që i ndezin fëmijët natën e verës e të Shëngjergjit, gjatë gjithë shëtitjes nuk do ta prishi a ta shkeli betimin. Larg nga trillimet e fantazitë, do të më falni për degresionet, se nga muzat josha jo vetëm Klion, Eraton, Polijmnien e Kaliopen. Të shkruajsh për Dibrën, vjen si me fillue shembjen e gërmimin e një mali me një kazëm. Të kishte lind në Dibër një Shekspir do të kishte gjetë brumë për sa drama e tragjedi, pa oborre mbretërore, do të gjente ca Halmeta, Othello, Makdufa e Makbetha, bile edhe Qezara pa kunora, por me kësula të bardha e xhurdi, ca Ofelie e Dezdemona, Xhuljeta pa unaza e xhevahire pa fustana kaftani, por të veshuna me jelekë e xhupa të qëndisme me bikme e gajtana. Po të kishte dalënji Sadi do të kishte shkrue sa Gjylistane e Bostane nëpër mexhilisët e Dibrës. Dhe mexhilisët e odat e Dibrës ishin skena e tribuna të thjeshta, aty shoshiteshin e siteshin në sitë të hollë mendjet, punorët dhe ngjarjet e ditës, të kohës, zanjet, grindjet e ngatërresat njani me tjetrin, punët e mira e të këqia, plot vemendje e kujdes , kufi në të folun, me nji oborrsi të tipit Dibran, larg thashethemeve, ku secili din vendin e vet, respekton moshën e epërsinë e tjetrit, kuvendime metafora e alegori, të njohura e me za, anekdoda trevave të afërta e të largëta, si për odat e mexheliset dibrane. Të kishte dalë një Tagore të shkruante për Dibrën me dashurinë që shkruante ai për Bengalin, të kishte kalue nëpër Dibër nji Viktor Hygo do të kishte mbushë sa e sa volume me ode e ballada, do të gjente legjenda, do të gjente burime të shkruante mostra të njillojta me "Të mjerët', "Orientalet", "Viti nandëdhjet e tre", "Legjenda e shekujve" etj, sidomos një vepër të ngjashme me " Ndëshkimet". Nuk po përmendim një Gëte apo një Dante, se në Dibër s'do të gjente nji Faust budalla, të ja shesë shpirtin shejtanit, e ky tjetri s'do të gjente nji Beatriçe në Dibër , që ta tradhëtojë, se Dibrania ashtë besnike. Për poetët, shkrimtarë e historianë, Dibra ashtë nji thesar i pa zbuluem. Dhe unë, si nji lipsar i mbetun i rraskapitun nga udhëtimi, i etun e i unët, i afrohem ngadalë e me drojte, se mos vallë s'meritoj sado pak të endem rreth tij, t'i gjej anën apo fillin, si me u gjetun para nji sofre të shtrueme me të mira prrallore, e s'din ku me prek ma parë, e ta shuej kërshinë, i sigurtë se do të gjej në mes të padijes, mençurinë në mes të ergësirës, butësinë e dashurinë, më mes të skamjes, begatinë, dhe kudo në shkrepa, male, fusha, historinë. Çdo vend ka bukuritë e veta, që i ka dhurue natyra, por mue më duket se peisazhet e panoramat e bukura e mahnitëse që ka Dibra s'i ka asnji vend tjetër. Dhe këto janë të ndryshme me ndërrimin e stinëve, gjatë lindjeve e perëndimeve të diellit e të hanës, tabllo të panumurta në agime e muzgje, që patjetër ndikojnë në formimin e temperamentin e karakterit të dibranit, që kur lind e rritet në kët vend. Për insikt apo intuitë, si gjarpëri lara lara që zgjedh ahun pulla pulla të bardha, ergësirat marrin ngjyrën e gjethi të pyllit, që i strehon, për mimetizëm edhe njeriu e vendi harmonizohen, e duen dhe e mbrojnë njëri tjetrin në çdo rast e kohë. Sa e sa lufta ka ba dibrani për ta mbrojtur vendin nga armiqtë lakmitar , t'egër e barbarë, dhe sa ndimë u dha vendi. Çdo kreshtë mali kthehej në nji kala me bedena, çdo shpat, çdo grykë e luginë ishte fortinë pët të zotin dhe varrezë për të huejn. Edhe Drini jo më pak ka ba ba batërdinë, si enkas i mat natyra se kur duhet të vërshojnë, turbullt valë e furi, dhe kur të rrjedhin qetë e qetë pa u ndi. Hije randë ashtë Dibra, e ka shënue nëpër harta mbretën e krala, se ky vend së pari duhet, o me luftë o me dredhi, kur të nisen për me hy në Shqipëri. Dhe parajsë më duket Dibra, plot me engjëj, që e mprojnë, si Serafina, por sa keq që ka edhe luçiferë. Janë këto tipare karakteristika të këtij vendi, që e bajnë dhe dibranin sedërmadh e krenar si natyra si me art të veçantë, e ka krijue e shndërrue, nga një vullkan me kratere në nji rrafshnaltë rrethue me male si kunorë, ata sirte ku të çveshme, e të nalta, ku të blerta e të pyllëzueme. Nji bukuri e hije të rrallë, kryevepër e saj e përsosun që e mahnit dhe e magjeps çdo soditës kureshtar. Megjithëko Dibra asht hijerandë. Pashallarët e Turqisë, sa herë niseshin nga Stambolli me urditë e tyre ndëshkuese, Dibra ngrente krye, sapo të merreshin rrugët e Edrenesë nëpër Selanik e Manastir. Me zemra të ngrime, zabitllarë e neferë, mbanë asqeri si me mosbesim e pasiguri, e dijshin se çdo hap i çonte drejt vdekjes. Dibra u dukej si humnerë. Dibra ishte nji vend ku do të ndesheshin, të kacafyteshin e të kapërtheheshin për jetë o për vdekje. Ata nën urdhnat e detyrueshëm e këta për me mbrojtë atdheun e vet. Ma vonë edhe nga ushtritë serbomëdhenj nga grykat e Radikës e të Ohrit, nga malet e Korabit e të bjeshkëve të Zharranicës u mësye Dibra, mbarë çohej vendi në kambë nga shtatë e shtatëdhjetë, me kësula e pa kësula, me besa besë, banë kërdi e i mbushën përronjtë e krastat me të vramë shapkali. Kjo asht Dibra e nandë maleve, dhe vinë tue pyetë të huejt. "vallë ku janë malet e Dibrës"? U kishte hy për palce tmerri, lemeria e paniku. Dibra ua kishte shty tërcëllimën dhe ata ja kishin pi panxhën këtij vendi historik.

Qëmoti u ka mbet numri nandë maleve të Dibrës. Si male janë Korabi, Granca, Skërteci, Hinoska, Kërçini, Jabllanica, Pllaja, Xharxhishti e Kreja, por asnji nga këta nuk përmenden në radhën e nandë maleve të Dibrës. Nga bisedat e vendit të nandë malet e Dibrës janë: Dy malet e epra, Çidhna, Dy Grykët, Bulqiza e Golloborda, Reçi e Dardha, Muhur e Luzni, Katër Grykët. Përmendet dhe Selishta. Pashallarët e huej kanë pyetur ku janë, e dibranët vetë s'bijen në një fjalë, sa janë e cilët janë, e zani u ka dalë për nandë malet e Dibrës. Mirdita ndahej në bajraqe, dymbëdhjet, kurse në Dibër s'ka pasur bajraktarë përpos bajraktarit të Lurës e njenit formal bajraktari i Çidhnës. Edhe Lura njëherë numërohej si krahinë e Matit, njiherë e Dibrës. Dibrani pëlqen ma shumë emnin mal se bajrak. e pra metaforikisht kuptohet se nandë malet e Dibrës janë nandë krahinat e saja ma të dallueme, për ç'i ka ra këtij vendi, për të mirë a për të keq, gjatë sundimit otoman. Por edhe gjatë kësaj kohe Dibra thuajse ka qenë gjithnji vend pothuajse i lirë, e ndreqte e prishte zakoni e kanuni i vet i Dibrës, me pleqtë e çekiçët i ndajshin çdo grindje e mosmarrveshje që kishin dibranët në mes tyre. Për vrasjet numroheshin gjaqet në mes palëve, e ngelshin gjak për gjak ose i falshin të tepërtat, por kurrë me u pague me të holla, siç e përmban kanuni i Lek Dukagjinit, se gjaku ose falet ose mbetet. Pra malet e Dibrës janë ato xhivare e krahina, me zakone pak a shumë të njëllojta, që flasin një shqipe me dialektin dibran, i trashë në të folun, sidomos në Dibrën e poshtme, i stërholluem e tipik në Dibrën e epërme. Kjo e fundit përfshin qytetin e Dibrës, që vendasit i thërrasin "Sheher" ose Dibra e madhe. Kështu u thonë edhe Dibra e epër e Dibra e poshtme dhe Dibra e madhe e Dibra e vogël. Dy malet e epra dhe dy malet e poshtme ishin si të thuesh dy krahët e shqiponjës dibrane, të dy grykët e Muhurri pjesët e tjera të trupit, ndërsa mendja e qendra e saj ishte Çidhna e Poshtme. Dhe e mendjes dhe e pushkës, dhe e sofrës. Çidhna ishte fodulle. Nandë malet e Dibrës i njihte edhe Stambolli, i sundonte me shumë takt e marifet, herë me t'urtë, herë me të egër e me ekspedita ndëshkimore, na ndërronte mvarësinë ose nën Sanxhakun e Ohrit, ose nën atë të Prizrenit. Edhe Valiu i Shkodrës shumë herë përzihej në punët e Dibrës. Të nandë malet kishin katër oxhaqe: Oxhaku i Hoxhollit në Dibër të madhe, Hysenagollit në Dohoshtisht, i Karasanit në Brezhdan dhe i Xhilagës në Deshat. Sejcili nga këto oxhaqe kishte influencën e vet në zona, si të përcaktueme, simbas fiseve, që i njifshin këto oxhaqe si për zot.

Marrë nga libri "S'ka qetsi në Lisivalle"

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Sheh Mera zbret në konakun e Fik Remës

Nga **NAIM PLAKU**

Aso kohe patën ardhur do sene të turbullta. Edhe Zalli me ato pak shtëpi të mbështetura në faqe çuditej me rrapëllimet e Drinit që sillte asaj vjeshte kërcuj e degë, gjë të gjallë që i kishte përlarë rrugës. Dukej vërtet i frikshëm. Në odën përdhese të një shtëpie matanë urës, fare pranë Drinit po soste ditët Fike Rrema me dorën e djathtë cung që i kishte mbetur diku, në shkëmbinjtë e Kolosjanit duke u kacafyt e ther trup me trup me shkjaun. Kishte ditë që s'kishte trokë kush në konakun e tij. Me dorën e majtë merrte llapushen e duhanit dhe e mbushte me të grirë, e vinte në buzë puron duke afruar ngadalë te gacat e prushit të vatrës. Sa filloi të rehatohej hyri Kalisja, nusja e djalit të madh:

- O babë, sheh Mera kaloi urën. Duket se këndej e ka kryet!

- Mbushe oxhakun mirë. Eh! – ofshani si me nguca Fika.

Dhe vërtet qeni i avllisë nisi të lehë atje në kotarin e tij, siç e kishte zakon, kur vinte ndonjë mik, pa i tundur zinxhirët e rëndë. Sheh Mera kishte zbritur nga Kraja enkas për të bërë teklif Fik Rremën, që e kishte postat e çuar në derexhe pleqëria e plagët. Kishte dy vjet që, pasi kishte marrë dorë mirë diku në Shkup ishte ulur në këmbë të sheh Osmanit. Një palë tespinj i kishte futur në xhepin e vogël të jelekut dhe vetëm një cullufe tirrje boje alle i varej afër shkekës së majtë. Një mjekër e rimtë, e sermët i jepte djaloshit gjunjë të fortë për të ecur edhe më shpejt mes dy brigjeve: Luftës dhe paqes.

- Të gjeta, o mixhë! – foli sheh Mera i pari duke e përqafuar Fikën.

- Nuk pata hyrë në zabel, por edhe në zabel, ai që do, shef trakun e gjen lakun. M'u ba qejfi që ndërrove emër. Paç ymer, jarebi! Faqja e bardhë e do një marame e po qe namazbez ka nur dhe natën.

- Më rri ke emri, o bashi i mikut! – filloi të flasë, si zu vend sheh Mera. – Nuk kam shtat për të veshë tre emra. Këmishën e bardhë "Ymer" ma veshi baba, çallmën e bardhë "sheh Ymer" ma ngjiti mejtepi i Shkupit, hekurat "Ymer Shehu" më thirri burgu...

- Shumë i turbullt po na vjen Drini. Këto sene s'i kemi provue kurrë. Është mbushë bregu me kërcunj e po na prish bereqetet lloha e rëra. Më ka çudit Kalisja sot. I kishin thënë se kishte qitur Drini në breg një mushkë barsë. U çova një fjalë ta rrjepin mushkën, t'i nxjerrin barkut këlyshin, do Zoti nuk është femër! Lëkurën le t'ia varin te Lisi i Begjit.

- Femër është, femër. Zoti na ruajtë! – foli duke thithur filxhanin e tretë të kafes me njërën dorë e me tjetrën cigaren, sheh Mera.

- Siklet, a? Si herët i ke nis takëmet, o sheh.

- Kur kalon nëpër arën e urofit s'ke pse mos të ngjiten rrodhëzat. Duhanin e kam ndez e fik, o bashi i mikut, kafen nji mbas nji e vetëm fjalën kam qejf ta përtyp, se po doli, nuk futet më në hambar.

- Të njoh, - i tha Fikja duke e parë drejt në sy sheh Merën. – Në katër breza fisi bën emër, do punë emri, o biri i Osmanit. Nuk zbardhet as me ujë e as me gjak.

Të dy kishin ngulur shikimin në drurët që flakëronin në oxhakun e nxirë dhe i jepnin konakut një pamje të këndshme që ndillte bisedën. E prishi heshtjen një kërcitje e fortë e drurëve që digjeshin.

- Pafllon shumë bredhi, o sheh Mera. Dru i lehtë është, por kërcet shumë kur digjet.

- Hyn në halèt për çdo gjë, por për oxhak s'e ke.

- Oxhaku ka qejf dushkun, të ngroh e nuk pallon. A në këmbë u shkunde teposhtë? – pyeti pas pak Fik Rrema duke ngrohur në zjarr cungun e dorës.

- Desha të marr kalin, por s'kishte leqe samari. Jam mësuar që i vogël t'i vë këmbët në leqe. Pastaj, është sevap të ecësh në këmbë tek miku i zemrës.

Pasi dredhi dy cigare, një ia lëshoi Fikes dhe duke e vështruar drejt në sy i tha:

- Kam ardhë, o Fik Rrema, të të shoh, të pyes dhe ... të marr.

- Qofsh me nder! Fol, por s'di kam apo s'kam me të dhënë.

- Larg qoftë, kam parë zjarr në teqe! Edhe varret të trazuar, o mik..

Fik Rrema ngrohu përsëri cungun dhe me një buzëqeshje të ëmbël iu drejtua djalit:

- Paske pa isharét të mirë, o djali i Osmanit. Aty ku bije zjarr rinë një bar më i mirë, pa ferra e grrica, kullosa del më e pastër. A e di se hàmullës i vemi flakën për të marrë më shumë bereqet. Mos u mërzit! Hollohet peri, por nuk këputet. Ke për të parë. Ishalla do jemi gjallë.

Fik Rrema vdiq dy vjet më vonë. Sa keq! Sheh Mera udhëtoi gjithë natën udhë e mbi udhë që të bënte një detyrë shpirtërore, t'i lante xhenazen e t'i falte namazin mikut të tij, atij burri që i pati marrë diçka nga mendja e tij e ndritur dhe përvoja e dhimbjeve të ruajtura me aq kujdes në cungun e dorës, që sa herë e lëndonte, i kullonte gjak.



Shpjegime fjalësh e shprehjesh:

1) Sene - kohëra. Thuhet zakonisht për katër stinët, senja e tretë - vjeshta e tretë.
2) Soste ditët – Kalonte pleqërinë.
3) Troke – ardhur, s'kishte takuar njeri, s'i kishte ardhur kush në derë.
4) Llapushe-a, at, em – gjethe e madhe e bimëve të egra, këtu gjethja e duhanit.
5) Kotar – kolibe.
6) Bërë teklif – për t'i bërë vizitë.
7) Postat – lodhur/ derexhe – në frymën e fundit, pa ditë mbrapa.
8) Ishte ulur në këmbë të sheh Osmanit – kishte zënë vendin e tij në Teqe.
9) Tirrje – penj të mëndafshtë që përdoreshin për qëndisje e zbukurime.
10) Mahrame – (këtu) perde / Namazbezi – Beze, pëlhurë e bardhë për t'u mbuluar në falje namazi.
11) Shumë i turbullt po na vjen Drini – Këtu dhe më posht aludohet për ardhjen e regjimit komunist të Enver Hoxhës në malësi e kudo në Shqipëri.
12) Do Zoti nuk është femër – do Zoti nuk i ka ditët e gjata.
13) Pafllon – kërcet, bën "paf" (onomatope). Pallon shumë – është fjala për regjimin.
14) T'i vë këmbët në leqe – të mbështetem diku për të mos shkarë.
15) Rinë – mbin si push, sa del nga toka bima.
16) Ngucë-a, at, em – ngacmoj, nguc, lëndoj dikë me fjalë.

Sheh Ymeri i Reçit (Ymer Shehu)

Reç e Dardha, një ndër 9 malet e Dibrës, ka nxjerrë figura të shquara që meritojnë të zënë vendin e tyre në historinë tonë kombëtare. Në vargun e tyre është padyshim dhe Sheh Ymeri (Ymer Shehu) nga Kraj-Reçi, që mbuloi për gati një shekull (1907-2001) shërbime të çmuara në emër të fesë islame, me një përkushtim të pashoq e dhunti me vlera të mëdha për tërë krahinën dhe më gjerë, aty ku deshi nevoja.

Lindi në familjen e Sheh Osmanit me tradita shumëvjeçare besimtarësh, që i dhanë emrin e mirë Teqes së Reçit, e vetmja përtej Drinit. Babai Osmani dhe nëna Sulltane realizuan dëshirën e tyre që djalin e tyre ta pajisnin me arsimin e nevojshëm, për të qenë një shërbyes i devotshëm i fesë dhe i Teqes. Mbaroi medresen e Shkupit me rezultate të shkëlqyera, duke mbartur edhe virtytet që i trashëgonte nga familja, ndershmërinë, punën, trimërinë, besën dhe përkushtimin për të ndjekur ritet e fesë islame. Veprimtarinë si imam e ushtroi kryesisht në fshatin e tij, por shërbesat fetare i kryente për tërë krahinën, aty ku e kërkonte puna.

Ai u shqua jo vetëm si imam i përgatitur e me dije të gjithanshme, por edhe në vepra bamirësie si pajtime gjaqesh, hasmërish, sherresh e ngatërresash, që ishin pasojë e një vendi pa shtet, pa ligje, pa kujdesje. Mori pjesë në kuvende të rëndësishme, ku fjala e tij vendoste e dëgjohej me vëmendje. Ndante pleqëri e vinte itifak. "Ka thënë sheh Ymeri...", e "ta pyesim një herë sheh Ymerin" – tregonin besimin që kishte populli të mençuria e fjalës së tij.

Regjimi totalitar i E. Hoxhës qe me pasoja për çdo klerik, për çdo institucion fetar. Dhe sheh Ymeri ndiqej e survejohej dhe praktikat e tij fetare filluan të shikoheshin me sy të keq. Në vitin 1947 e pati shumë të vështirë të plotësonte dëshirat shpirtërore, të kryente shërbesat fetare, ashtu siç dinte e donte.

Në vitin 1990 humbi bashkëshorten e devotshme me të cilën pati dy djem e 5 vajza. Vitet e fundit u vendos në Laknas të Tiranës familjarisht. Kurrë nuk e ndali punën në emër të fesë e bamirësisë. I papërtuar gjendej kudo në shërbim të njerëzve në nevojë, me një përkushtim të jashtëzakonshëm, duke fituar famë e nderime në gjithë vendin dhe më gjerë.

Më 20 tetor 2001 ndërroi jetë në moshën 95 vjeçare në Laknas të Tiranës biri i denjë i Reçit dhe i Dibrës, imami i shquar e besimtari i papërtuar, bamirësi dhe njeriu i mençur, i rrethuar nga dashuria e përjetshme e njerëzve të familjes dhe gjithë atyre që njohën e provuan dorën e ngrohtë e të bardhë të sheh Ymerit.

Në varrimin e tij mori pjesë Dibra e Tirana, krejt vendi e matanë kufirit, duke i dhënë lamtumirën për në jetën e pasosur këtij besimtari të shquar. Pikërisht për këto merita u shpall "Nderi i Komunës" nga banorët e Reçit.

Këngë për sheh Ymerin e Reçit



Lindi në Kraj – Reç më 1907, në familjen e njohur të sheh Osmanit, nga kishin dalë mbi nëntë breza besimtarësh të shquar islamë. Kishte mbaruar medresenë e njohur të Shkupit dhe ushtroi aktivitetin në teqen e Kraj-Reçit. U ndoq dhe u burgos, por kurrë nuk e ndali veprimtarinë fetare. Pajtoi shumë gjaqe e ndali qindra sherre e hasmëri në mbarë Dibrën e më gjerë. Vdiq në moshën 95-vjeçare, duke marrë me vete titullin e merituar "Nderi i Reçit".

1) E thoshte vetë sa ishte gjallë: "Pata tre emra: Ymer nga baba, sheh Ymeri pasi mbarova medresenë e Shkupit dhe Ymer Shehu burgjeve të komunizmit.

Po ndijo, o udhëtar,
Kur të shkosh në Reç e Dardhë,
Kur t'kalosh nëpër Kraj-Reç,
Ndalu pak se asht nji teqe,
Kur pret Drini maja e kreshta,
Ka ba emër që nandë breza,
Pyet, se malet bijen haberin:
- Mos harroni sheh – Ymerin!

Sheh Ymeri pat tre emra,
Nji prej babe e dy nga jeta!
Përmbi kullë ra dritë e bardhë:
- Nanë Sulltana lindi djalë!
Dhe u rrit me fè e dije,
Çallmë e bardhë i rri mbi krye,
Në kuvend ku plasën sherri,
Ndan kanuni Ymer Shehi!

Çdo epokë në histori
E ndëroj emrin e tij
Në luftë, në burg e në liri,
Në terror e n'demokraci,
N't'keq e n't'mirë s'e ndal shërbimin,
Në Islam ka lidh betimin.
S'e tremb burgu, s'e ndal terri:
- Paç rahmet, o sheh Ymeri!

Në tetor dymijë e nji,
Reç-e-Dardha po mbajnë zi,
Drini e Dajti sjellin gjame:
- Sheh Ymeri na ka lanë
Dëgjo Dibrën çfarë po thotë,
Gjithë Tirana asht përlotë:
- Sheh Ymeri ka ndërrue jetë,
Lum si ai, xhenet ka gjetë!

Lum kush rron sa të jetë jeta,
Që pas vdekjes i rritet vlera,
Ej, sa nana e bekojnë,
Ej, sa duer n'varr po e shtrojnë,
Sa urime po merr ky sheh,
Qindra pushkë i la pa shkreh,
Nguli besë e itifak,
Ndali gjak e mbylli plagë!

Asht nji varr n'Laknas t'Tiranës,
Ku ndal vrapin zemra e nanës,
Ku çel lulja n'prag të derës,
Ku nis këngën zogu i verës:
- Ndalu pak, o udhëtar,
Ulu e puth dorën e bardhë
Fjala e Zotit, besa e nderi
Gjetsh rahmet, o sheh Ymeri!

Tiranë, qershor 2007

Trupa e teatrit profesionist të pallatit të kulturës së Peshkopisë "Haki Stërmilli" shaq dramën "Letër Orestit"

"Tragjedia ka ndodhur në Dibër"





Tragjedia e Klitemnestra ka ndodhur në Malet e Dibrës.

Ky ishte imazhi që krijon pasi ke parë monodramën "Letër Orestit", e cila u shfaq në teatrin Kombëtar më 20 Qershor në Tiranë.

Trupa e teatrit profesionist të pallatit të kulturës së Peshkopisë "Haki Stërmilli", shfaqi të shtunën më 20 qershor 2007, monodramën "Leter Orestit" te autorit Jakovos Kambanelis, e cila u mirëprit nga artdashësit. Shfaqja e vënë në skenë nga regjisorja Sonila Kapidani kishte si protagoniste aktoren Rozina Kostani, ndërsa skenograf i saj ishte Erald Bakalli.

Nga errësira e skenës vijnë fjalët e nënës që i shkruan të birit, e cila prêt të ndodhë një tragjedi, pasi kështu e kanë thënë hyjnitë. Por Klitemnestra nuk do të iki nga kjo botë pa ia treguar hyjnive, por në radhë të parë, djalit të saj, Orestit tragjedinë e jetës së saj. Ajo e di se pas një krimi vjen një krim tjetër. Ajo e ka vrarë Agamemnonin, pasi ai i kishte flijuar vajzën e saj për t'u bërë qejfin hyjnive dhe për të fituar luftën e tij. Dhe tashmë ajo e di mirë se i biri do ta vriste, për të marrë hak për vrasjen e të atit. Në këtë kontekst ajo po përgatit testamentin e saj, për të treguar gjithë të vërtetën në marrëdhëniet e saj me Agamemnonin. Ajo tregon se si nga dashuria erdhën në jetë dy vajzat, por ato nuk i duheshin Agamemnonit. Atë që deshte Agamemnoni, Orestin, erdhi në jetë si pasojë e dhunës.

Klitemnestra po përgatit në errësirë letrën për Orestin. Në këtë moment, para se të shfaqet drita në skenë, vijnë tingujt e fyellit, ndërthurur me tingujt e lashtë të bririt, trokitjes së gurëve, të cilat i dhanë monodramës një sfond tragjik, duke e lënë shikuesin në ankth deri në përfundimin e saj, pavarësisht se çdokush e di mirë përfundimin.

Monodramat janë të vështira për publikun, por muzika e Përparim Tomçinit, e bëri publikun të priste deri në fund me ankth përfundimin. Dhe i dha imazhin monodramës se ajo nuk kishte ndodhur diku në Greqinë e lashtë, por mu aty mes maleve të Dibrës ku dëgjohet fyelli dhe daullja.

Për vënien në teatër të monodramës "Letër Orestit", me autor Iakovos Kambanelis, bashkëpunuan edhe Armela Demaj (ass.regjisore), Klajd Kapidani (ass/skenograf), Hysni Loka (kostumograf), Adnan Elezi (ndricimi) dhe Arben Kacani (punëtor skene).

Ndërsa Rozina Kostanin, aktoren e vetme në skenë e shoqëruan në role pa zë edhe P.Tomcini, Sh.Xhajku, A.Demaj dhe E.Muca.

Shfaqja "Letër Orestit" u bë e mundur edhe falë kujdesit të Kryetarit të Bashkisë, Peshkopi, z. Ilir Krosi.

B.K.

Dibra vazhdon traditën e bukur në sportin e mundjes




Edhe këtë vit ekipi 'Korabi' i mundjes u shpall kampion në qytetin e bukur bregdetar të Durrsit. Kampion ky ekip u shpall edhe vitin që shkoi në Pukë. E këtë traditë të bukur në këtë sport burrëror dibranët e ruajnë prej vitesh. Kanë kaluar vite por Dibra nuk i harron ato mundësa që nderuan ekipin e tyre nëpër kampionate kombëtare. Dhe jo vetëm me ekipin "Korabi" por dhe me ekipe të tjera që kanë qenë mundësit dibranë janë klasifikuar gjithmonë si më të mirët.


Ndër to mund të përmendim Avni Halili,Xhelil Cibaku,Ilir Gjiza, Ferik Reçi, Shemsi Shini, Meleq Zajmi, Xhemal Skarra, Fiqiri Rama,Ivzi Muça, Mentor Karasani, Jashar Ibrahimi, Fiqiri Osmani, Fehmi Sejdini, Mazllum Tola, Këto rezultate janë arritur në saj të trajnierit të talentuar Fiqiri Rama i cili edhe pse në kushte jo të përshtatshme dhe tepër të vështira si pa tapet, veshmbathje e vegla stërvitore prej shtatë vjetësh ekipi i mundjes "Korabi" shpallet kampion.


Këtë vit kampionati që u zhvillua në qytetin bregdetar të Durrsit nga 14 ekipe pjesmarrës ku Tirana e Durrsi përfaqësoheshin me nga dy ekipe, djemtë e "Korabit' ishin më të mirët me 50 fitore dhe vetëm 3 humbje. Me këtë rast si ekip mundje falenderojmë biznesmenin dibran zotin Musa Riçku i cili sposorizoj për pregaditjen e ekipit që të ndeshej dinjitoz në këtë kampionat.

Fiqiri Rama

BOTIME TË REJA TË AUTORËVE DIBRANË











Kërkohet të dhëna për mësuesen Belkize Abdullullahu

Quhem Nehat Jahiu.

Desha ndihmën e cdonjeriu, i cili ka mundësi të më ndihmojë për disa të dhëna mbi Belkize Abdullullahu, e lindur ne Diber me 1940. Ka punuar ne shkollen fillore "Shaban Beqiri" te fshatit Sllupcan, kumuna e Likoves, rrethi i Kumanoves. Gjate viteve 1955, 1956, 1957 ka punuar ne shkollen e lartpermendur. Kam te dhena, por jo te sigurta se gjer ne pension ka punuar ne fshatin Rahovic te Presheves si mesimdhenese. Njeherit kam te dhena, poashtu jo te sigurta, se tani nuk jeton më.

Kerkoj te dhena te sakta dhe nje fotografi. Kur sakte eshte e lindur, kur ka vdekur dhe ne cilin vend.

Keto te dhena me nevoiten per pergatitjen e nje monografie te shkolles.

Për kontakt: email: nehat-j@hotmail.com; **ose nehat_j@yahoo.com.**

*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745***